

Komiteti Ekzekutiv i FFK-se, në bazë të nenit 3.3, pika 3, a) të Statutit të FFK-së, në mbledhjen e vet të mbajtur më datën 30.07.2019, aprovoi këtë:

RREGULLORE E GARAVE E LOJËS SË FUTBOLLIT 2019/2020

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1 Rregullorja mbi garat e futbollit përmban dispozitat themelore mbi sistemin e garave të përhershme dhe kushtet e përgjithshme të garave.
- 2 Me gara të përhershme në kuptim të kësaj Rregulloreje konsiderohen garat kampionale dhe të Kupës të cilat zhvillohen çdo vit garues.

Neni 2

- 1 Të gjitha ndeshjet publike të futbollit të meshkujt dhe femrat të cilat në Kosovë i organizon FFK-ja me organet, organizatat dhe anëtarët e saj, zhvillohen sipas Rregullave të Lojës së Futbollit të cilat i nxjerr Bordi Ndërkombëtar, ndërsa i shpall Organizata Ndërkombëtare e Futbollit (FIFA).
- 2 Ndeshjet në futboll të vogël zhvillohen sipas Rregullave të Posaçme të Lojës për Futsall të cilat i nxjerr Bordi Ndërkombëtar.
- 3 Vendimet për zbatimin e Rregullave të Lojës së Futbollit të Bordit Ndërkombëtar në kuadër të autorizimeve të veta i bjen Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, ndërsa udhëzimet më të afërta për zbatimin e këtyre vendimeve i japin organet gjegjëse të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së (në tekstin e mëtutjeshëm: Komiteti Ekzekutiv – KE).
- 4 Tekstin zyrtar të Rregullave të Lojës me vendimet e FFK-së për zbatimin e rregullave të lojës dhe udhëzimeve i shpall FFK-ja.

II SISTEMI I GARAVE TË PËRHERSHME

Neni 3

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së përcaton sistemin unik të garave të futbollit në nivel të Kosovës dhe nxjerr dispozitat e përgjithshme të garave të përhershme për tërë territorin e Kosovës.

Neni 4

- 1 Vendimet mbi sistemin e garave përmbajnë:
 - a. Mënyrën e garimit: sistem i pikëve apo sistem i kupës;
 - b. Rangun e garave;
 - c. Ligat garuese, grupet në kuadër të rangut të njëjtë të garave;
 - d. Numrin e klubeve (ekipet garuese) në rangun e njëjtë;
 - e. Mënyrën e fitimit të së drejtës në gara në rangun gjegjës të garave dhe grupit garues;
 - f. Kushtet të cilat duhet të përmbushen nga klubet (ekipet garuese) në rangun e caktuar të garave.

Neni 5

- 1 Sistemin e përhershëm të garave në të gjitha rangjet e garave të Kosovës (Superliga, Liga e I-rë, II-të) e cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Sistemi duhet të jetë në përputhje me sistemin unik dhe dispozitat e përgjithshme. Komiteti Ekzekutiv i FFK-së i cakton organet dhe komisionet të cilat udhëheqin dhe mbikëqyrin këto gara.
- 2 Komiteti Ekzekutiv i FFK-së i emëron komisionet përkatëse të garave në përbërje prej së paku 3 anëtarëve të cilët do të udhëheqin me gara. Garat e futbollit të Kosovës zhvillohen me sistem të dyfishtë (vajtje-ardhje) apo të trefishtë apo edhe ndryshe, sipas kalendarit të garave të verifikuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga KE i FFK-së. Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas Rregullave Ndërkombëtare të Futbollit(IFAB) të aprovuara nga UEFA.

Neni 6

- 1 Vendimi për ndryshimin e sistemit të garave nxirret (merret) më së largu një vit përpara fillimit të garave.
- 2 Propozimin për ndryshimin e sistemit të garave mund ta bëjnë KE, Lidhja Rajonale e Futbollit, organizatat profesionale (e referëve, trajnerëve, etj.) dhe shoqatat e klubeve të futbollit, ndërsa vendimin e bjen KE i FFK-së.

Neni 7

Garat mund të organizohen sipas sistemit të njëfishtë, dyfishtë, trefishtë, të Kupës ose sipas sistemit të njëfishtë, dyfishtë apo të katërfishtë të pikëve ose sistemit të kombinuar, pastaj sipas sistemit të pikëve dhe sistemit të Kupës, e në raste të posaçme, në sistem të turnirit.

Neni 8

- 1 Mënyrën e udhëheqjes së garave të rangut të Superligës, Ligës I, II, U-19 dhe Ligës Nacionale për U-17, e përcakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.
- 2 Lidhjet Rajonale të Futbollit në sezonën 2019/2020 i organizojnë garat e kategorive A të të rinjve: U9, U11, U13, U15 dhe U17, sipas autorizimeve të KE-së dhe në bazë të akteve normative të FFK-së.

Neni 9

- 1 Rregullorja e Garave është unike për garat në Superligë, Ligën I dhe Ligën II, ndërsa kategoritë U19 dhe Liga U17 kanë rregullore apo propozicione të veçanta si edhe kategoritë e reja që garojnë në kuadër të Lidhjeve Rajonale të Kosovës. Këto akte i miraton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.
- 2 Me rregulloren e garave më për së afërmi përcaktohen rregullat për zhvillimin e garave. Rregullorja e garave përcakton dhe vërteton kushtet sipas të cilave zhvillohen garat, pastaj thekson organet të cilat udhëheqin me gara si dhe të drejtat dhe obligimet e tyre, si dhe çështje të tjera që parashihen me këtë Rregullore.
- 3 Rregullorja e garave nuk mund të jetë në kundërshtim me Statutin e FFK-së si dhe aktet e tjera të UEFA-s dhe FIFA-s.
- 4 Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të Rregullores së Garave dhe dispozitave të përgjithshme të Rregulloreve të UEFA-s dhe FIFA-s, do të aplikohen ato të UEFA-s dhe FIFA-s.

III GARAT E PËRHERSHME

Neni 10

Gara të përhershme në territorin e Kosovës janë:

- 1 Kampionatet e futbollit të Kosovës;
- 2 Kupa e Kosovës në futboll;
- 3 Kampionati i Kosovës për U19;
- 4 Kampionati i Kosovës për U17;
- 5 Kampionati i Kosovës në Futsal;
- 6 Kampionati i Kosovës në futboll të femrave.

Si gara të përhershme konsiderohen edhe kualifikimet për hyrje në rang më të lartë të garave, nëse ato parashihen me sistem të caktuar të garave.

Lidhjet rajonale, përmes Komisionit të Garave të grupeve përkatëse, organizojnë dhe zbatojnë në territoret e tyre garat e përhershme të klubeve, shkollave të futbollit si dhe marrin vendime lidhur me organizimin e garave kampionale që janë në kompetencë të saj.

IV KUSHTET PËR ORGANIZIMIN E GARAVE

Neni 11

- 1 Garat kampionale 2019/2020, sipas rregullit, organizohen në formë të Ligës sipas sistemit të dyfishtë të pikëve, që dmth secili ekip i një lige takohet dy herë më secilin anëtar të ligës së njëjtë, dhe atë njëherë si nikoqir dhe njëherë si mysafir. **Përrjashtim bënë Superliga e cila ka tri etapa me gjithsej 33 ndeshje, sipas sistemit të Bergerit.**

- 2 Superliga, Liga e Parë dhe Liga e Dytë janë të organizuara nga Sekretariati i Përgjithshëm (administrata qendrore dhe komisionet përkatëse), ndërsa Ligat Rajonale dhe mëposhtë organizohen nga LRF-të dhe mund të jenë të ndara në dy apo më shumë grupe, varësisht nga numri i ekipeve në atë ligë, dhe këtë e rregullon KE me vendim të veçantë.
- 3 **Në gara marrin pjesë vetëm ekipet e licencuara nga Komisioni për licencim i FFK-së për vitin garues 2019/2020 (Cetifikata për licencim 2019/2020).**
- 4 Numri i ekipeve në ligë dhe grupe përcaktohet me vendimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së mbi sistemin e garave një vit përpara çdo sezone (në rast ndryshimi të sistemit garues).

V PJESËMARRJA NË GARAT E PËRHERSHME

Neni 12

- 1 Klubet e Superligës, Ligës së Parë, të Dytë dhe të Tretë të Kosovës, mund të marrin pjesë në të gjitha garat e përherhme edhe kategorive të reja ("A", U19, U17, U15, U13, U11 dhe U9).
- 2 Në Lidhjet Rajonale marrin pjesë edhe akademitë dhe shkollat e futbollit me të gjitha grupmoshat.

VI KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR GARA

Neni 13

- 1 Kampionati i ri fillon nga data 1 Korrik dhe përfundon me 30 Qershor të vitit tjetër, ndërsa garat fillojnë në bazë të vendimit të KE me propozim të Komisioneve përkatëse të Garave (psh. Superliga me 17 gusht ndërsa përfundon më 30 maj të vitit të ardhshëm).
- 2 Viti garues është i ndarë në dy stinor: në stinorin vjeshtor dhe atë pranveror.
- 3 Superliga ka 12 ekipe të cilat do të garojnë me sistem të trefishtë garash, nga e cila në fund të sezonës 2019/2020 do të bien në një rang garues më të ulët (Liga e Parë) katër ekipet që do të rangohen nga vendi i 9-të deri tek ai i 12-të.

Shembull: renditja tabelare – plasmani përfundimtar i ekipeve në fund të sezonës 2019/2020:

SHEMBULL –SUPERLIGA

1	Ekipi Kampion
2	Ekipi Nënkampion
3	Ekipi
4	Ekipi
5	Ekipi
6	Ekipi
7	Ekipi
8	Ekipi
9	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, Liga 1
10	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, Liga 1
11	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, Liga 1
12	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, Liga 1

- 4 Liga e Parë ka 16 ekipe garuese ku në fund të sezonës 2019/2020 dy të parat do të inkuadrohen në një rang garues më të lartë (Superliga), ndërsa nga Liga e Parë do të bien në një rang garues më të ulët (Liga e Dytë A dhe B) ekipet të cilat kanë përfunduar nga vendi i 13-të deri në vendin e 16-të, në total 4 ekipe.

Shembull: renditja tabelare – plasmani përfundimtar i ekipeve në fund të sezonës 2019/2020:

SHEMBULL –LIGA 1	
1	Ekipi Kampion, Superliga
2	Ekipi Nënkampion, Superliga
3	Ekipi
4	Ekipi
5	Ekipi
6	Ekipi
7	Ekipi
8	Ekipi
9	Ekipi
10	Ekipi
11	Ekipi
12	Ekipi i cili vitin tjetër garon në Ligën e 2 Unike
13	Ekipi i cili vitin tjetër garon në Ligën e 2 Unike
14	Ekipi i cili vitin tjetër garon në Ligën e 2 Unike
15	Ekipi i cili vitin tjetër garon në Ligën e 2 Unike
16	Ekipi i cili vitin tjetër garon në Ligën e 2 Unike

- 5 Liga e Dytë do të ketë 16 ekipe. Kampioni dhe nënkampioni (vendi i I- rë dhe i II-të) do të hyjnë në Ligën e Parë, ndërsa katër ekipet e fundit në tabelë do të bien në Ligat Rajonale përkatëse.

Shembull: renditja tabelare për Ligën 2, plasmani përfundimtar i ekipeve në fund të sezonës 2019/2020:

SHEMBULL –LIGA 2	
1	Ekipi Kampion, që inkuadrohet në Ligën 1
2	Ekipi Nën Kampion, që inkuadrohet në Ligën 1
3	Ekipi
4	Ekipi
5	Ekipi
6	Ekipi
7	Ekipi
8	Ekipi
9	Ekipi
10	Ekipi
11	Ekipi
12	Ekipi
13	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, L.Rajonale
14	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, L.Rajonale
15	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, L.Rajonale
16	Ekipi i cili vitin tjetër garon në një kategori më poshtë, L.Rajonale

- 6 Ligat Rajonale janw dy dhe tw organizohen nw bazw tw afwrsisw teritoriale. Liga Rajonale mund tw themelohet me mw sw paku 6 ekipe. Fituesit e te dy Ligave do tw inkuadrohen automatikisht nw Ligwn e dytw unike.
- 7 Me to do të udhëheq Komisari i Garave që caktohet nga KE me propozim të LRF-ve përkatëse, poashtu edhe organet tjera si komisari disiplinor dhe komisari për delegimin e Gjyqtarëve.
Shembull: radhitja tabelare për ekipet e Ligave Rajonale, plasmani përfundimtar i ekipeve në fund të sezonës 2020/2021:

SHEMBULL-Liga Lidhjet Rajonale A dhe B

1	Ekipe të Kampionit që inkuadrohen në Ligën 2 (A dhe B)
2	Ekipe
3	Ekipe
4	Ekipe
5	Ekipe
6	Ekipe
7	Ekipe
8	Ekipe
9	Ekipe
10	Ekipe
11	Ekipe
12	Ekipe
13	Ekipe
14	Ekipe, etj. varësisht nga ekipet nr mund tw jetw edhe mw i madh

VII KALENDARI I GARAVE/ORARI I NDESHJEVE TË GARAVE TË PËRHERSHME

Neni 14

- 1 Ndashjet kampionale zhvillohen të shtunave, të dielave apo edhe ndonjë ditë tjetër nëse për këtë vendos Komisioni i Garave me kërkesën e kompanisë fituese televizive.
- 2 Komisioni i garave mund të vendosë që ndashjet e ndonjë xhiroje të luhen të mërkurën. Klubet, para fillimit të stinorit (të vjeshtës apo të pranverës), me rastin e licencimit të klubit, duhet të propozojnë se a do të luajnë si nikoqir të shtunën apo të dielën, por të drejtën për të vendosur për ditën dhe orën e zhvillimit të ndashjes e ka Komisioni i Garave dhe KE në raste të veçanta.
- 3 Klubi nikoqir, për ndashje të caktuar, mund të propozojë të ndryshojë terminin (nga e shtuna në të diel apo anasjelltas, apo edhe orën e zhvillimit të ndashjes) me kusht që të paraqesë kërkesë me shkrim (së bashku me arsyetimin përkatës) Komisionit të Garave i cili është i obliguar që të njoftojë edhe klubin kundërshtar, 3 ditë përpara terminit të ri të ndashjes.
- 4 Komisioni i Garave mund të vendosë që ndashja e paraparë për të shtunën apo të dielën të zhvillohet gjatë një dite pune, sipas marrëveshjes me shkrim të dy klubeve, të prezentuar në Komisionin e Garave së paku 3 ditë para zhvillimit të ndashjes dhe e vërtetuar nga ana e Komisionit të Garave si dhe nëse nuk ka ankesa nga klubet e tjera për atë ndashje e cila mund të jetë e rëndësishme edhe për plasmanin e ndonjë ekipi tjetër. Marrëveshjet e këtilla nuk do të pranohen për ndashjet e tri xhirove të fundit të garave kampionale.

- 5 Në interes të rregullsisë së garave, Komisioni i Garave, me pëlqimin e Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, mund të vendosë që ndeshjet e tri xhirove të fundit të kampionatit, të zhvillohen në të njëjtën ditë dhe në të njëjtën kohë. Komisioni i Garave mund të vendosë që ndonjë ndeshje të zhvillohet edhe jashtë rregullit të sipërm por vetëm nëse ajo ndeshje nuk vendos absolutisht asgjë në dëm të klubeve tjera.
- 6 Me kalendarin e garave përcaktohen terminet për zhvillimin e ndeshjeve të garave të përhershme, ndeshjeve zyrtare dhe të turneve.
- 7 Kalendarin nxjerret posaqërisht për çdo vit garues, dhe atë më së voni 15 ditë para fillimit të sezonit vjeshtor.
- 8 Kalendarin i rangut më të ulët të garave duhet të jetë në përputhje (pajtim) me kalendarin e garave të rangut më të lartë.
- 9 Kur në vend zhvillohen apo drejtpërdrejt transmetohen përmes televizionit ndeshje të rëndësishme ndërkombëtare, orari i ndeshjeve mund të ndryshojë, gjegjësisht të rregullohet, ashtu që lojtarëve, klubeve, publikut, etj. t'ju mundësohet përcjellja e këtyre ndeshjeve.

Neni 15

- 1 Terminet e përcaktuara me kalendarin e garave nuk mund të ndryshohen pa miratimin e Komisionit të Garave, në bazë të kërkesës së kompanisë fituese për transmetim televiziv apo në raste urgjente nga KE i FFK-së.
- 2 Përjashtimisht, për shkak të fuqisë madhore (Vis Mayor) dhe rasteve të tjera të paparashikuara, organi i cili udhëheq me gara mund të ndryshojë terminin e xhiros së caktuar (apo të më shumë xhirove), me atë që për xhiro (apo ato xhirove) të caktojë termine të tilla që nuk e çrregullojnë në masë të madhe kalendarin e garave.

Neni 16

- 1 Orarin e ndeshjeve të përhershme e përcakton organi i cili udhëheq me gara.
- 2 Orari i ndeshjeve caktohet me tërheqje të shortit. Në short hyjnë vetëm klubet e licencuara për atë vit garues dhe për atë kategori garuese. Tërheqja e shortit duhet të bëhet më së voni 15 ditë para fillimit të garave.
- 3 Orarin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjeve, veçanërisht për çdo javë-xhiro, e cakton Komisioni i Garave një javë para zhvillimit të ndeshjeve, duke pasur parasysh kërkesat dhe mudnësitë e klubeve.
- 4 Orari i ndeshjeve i përcaktuar sipas këtij neni mund të ndryshohet nga shkak i fuqisë madhore apo ndonjë rasti të jashtëzakonshëm, më së voni 3 ditë para ndeshjes, e lidhur me të, duhet të lajmërohen klubet si dhe organet zyrtare të ndeshjes.

VIII NDRYSHIMI I ORARIT TË NDESHJEVE

Neni 17

Orarin e përcaktuar dhe verifikuar të ndeshjeve kampionale dhe për Kupë mund ta ndryshojë organi i cili udhëheq me gara vetëm në bazë të kriteriumeve të përcaktuara me rregulloren e garave, me atë që shtyerja, ndryshimi i terminit të ndeshjes apo xhiros së caktuar të garave, nuk mund të shkojë

në dëm të ekipeve të interesuara, e as që mund t'ju japë përparësi ekipeve ndeshja e të cilave shtyhet në raport me pjesëmarrësit e grupit të njëjtë garues.

SHTYERJA E NDESHJES

Neni 18

- 1 Nëse ekipi i jep dy ose më tepër lojtarë për reprezentacionin (përfaqësuesen) e Kosovës për të zhvilluar ndeshjen e paraparë me kalendarë të garave, atëherë kërkesa e tij mund të ndryshojë orarin e zhvillimit të ndeshjes kampionale apo për Kupë.
- 2 Ndeshja mund të shtyhet për shkak të pjesëmarrjes së klubeve në garat ndërkombëtare, dhe për shkaqe të sigurisë. Ndeshjet e shtyera do të luhen menjëherë në terminin e parë të lirë, dhe këtë vendim e merr organi kompetent i garave (Komisioni i Garave).
- 3 Organi që udhëheq me gara mund të marrë vendim mbi shtyerjen e ndeshjes konform dispozitave të pikës paraprake dhe ka për obligim t'i njoftojë me shkrim në faqen zyrtare apo me email ekipet e interesuara, dhe atë më së voni tri ditë përpara terminin të përcaktuar me orar për fillimin e ndeshjes (termini i së cilës ndryshohet).

Neni 19

- 1 Nëse me vendimin e organit kompetent shtetëror, për shkak të ditë-zisë, ndalohet zhvillimi i shfaqjeve sportive ose ndeshja nuk mund të zhvillohet ditën e caktuar për shkak të fuqisë madhore (tërmetit, zjarrit, vërshimeve, etj.), atëherë të gjitha ndeshjet që është dashur të zhvillohen atë ditë shtyhen menjëherë (automatiksht).
- 2 Ndeshja e shtyrë do të zhvillohet të nesërmen në kohë të njëjtë nëse ka pushuar arsyeja e shtyerjes. Nëse ndeshja e shtyrë nuk mund të zhvillohet të nesërmen, atëherë Komisioni i Garave do të caktojë terminin e ri për zhvillimin e saj (mundësisht para xhirso së ardhshme), duke pasur kujdes që termini i ri nuk shkon në dëm të ekipeve të interesuara.
- 3 Para fillimit të ndeshjeve të cilat luhen pas kalimit të ditës së ditë-zisë shprehen ngushëllimet me një minutë heshtjeje në mënyrë të paraparë me Rregullat e Lojës së Futbollit. Me aprovimin nga Komisioni i Garave, sipas rregullave të caktuara nga UEFA/FIFA (Manuali i Delegatit).

IX KOHA E FILLIMIT TË GARAVE TË PËRHERSHME

Neni 20

- 1 Koha e fillimit të ndeshjeve të garave të përherëshme caktohet nga Komisioni i Garave duke pasur kujdes për rrethanat kohore, lokale dhe mediave, nëse ka interes për një gjë të tillë.
- 2 Në raste të veçanta, klubet kanë të drejtë të propozojnë terminin por për këtë vendos Komisioni i Garave.
- 3 Me rregulloren e garave mund të parashihet që ndeshjet e xhirove të caktuara të rangjeve të caktuar garuese apo të grupeve të rangut të njëjtë të zhvillohen në ditën dhe kohën e njëjtë.

- 4 Kohëzgjatja e ndeshjeve të futbollit përcaktohet sipas grupmoshës dhe gjinisë.
- 5 Kohëzgjatjet e ndeshjeve sipas grupomoshave:

TABELA

Kategoria A	2 x 45 Minuta	Vazhdimet	2 X 15 Minuta
U-19	2 x 45 Minuta	Vazhdimet	2 X 15 Minuta
U-17	2 x 40 Minuta	Vazhdimet	2 X 10 Minuta
U-15	2 x 35 Minuta	Vazhdimet	2 X 05 Minuta
U-13	2 x 30 Minuta	Vazhdimet	2 X 05 Minuta
U-11	2 x 25 Minuta	Vazhdimet	2 X 05 Minuta
U-9	2 x 20 Minuta	Vazhdimet	2 X 05 Minuta
Femrat	2 x 45 Minuta	Vazhdimet	2 X 15 Minuta
Futsalli	2 x 20 Minuta Aktive	Vazhdimet	2 X 05 Minuta
Futbolli në rërë	3 x 12 Minuta	Vazhdimet	1 X 03 Minuta

Neni 21

- 1 Për të gjitha ndeshjet e garave të përhershme Komisioni i Garave e cakton delegatin. Në rast se në ndeshje nuk vjen delegati, atëherë detyrën e delegatit do ta ushtroje Referi i Katërt.
- 2 Të drejtat dhe detyrat e delegatit janë (të përcaktuara në detaje në Manualin e Delegatit):
 - a. Që në praninë e përfaqësuesve të klubeve të vërtetojë identitetin e lojtarëve;
 - b. Të vërtetojë që trajnerët e kanë lejen gjegjëse për punë;
 - c. Konstatojë rregullsinë e ID-ve të futbollit dhe të drejtën për lojë të lojtarëve të paraqitur dhe ua tërheq vërejtjen përfaqësuesve të klubeve për mungesat dhe lëshimet e vërejtura;
 - d. Të vërtetojë praninë e referëve të deleguar, mjekëve dhe personave të tjerë zyrtarë që parashien me akte të përgjithshme normative;
 - e. Që pas përfundimit të ndeshjes merr deklaratat nga referët dhe personat e tjerë eventuale lidhur me sjelljet e lojtarëve, zyrtarëve dhe incidenteve eventuale dhe ato t’ia bashkangjesë raportit. Në mënyrë të njëjtë të veprojnë nëse janë larguar ose paraqitur trajnerët ose personat tjerë zyrtarë të klubeve.
 - f. Që të gjitha vrojtimet dhe vlerëimet e veta për dhe lidhur me ndeshje t’i cekë në raportin e ndeshjes, ose, nëse ka incidente dhe dukuri negative, në raport plotësues duke i bashkangjitur atij fotografi dhe dëshmi të prekshme ose fakte relevante.
 - g. Kryetari i Komitetit Ekzekutiv, në bazë të autorizimit të Komitetit, për ndeshjet e rëndësisë së posaçme, mund të caktojë super-kontrollën i cili përpilon raport të shkruar, vlerëson gjykimin e referëve, etj. Raporti i tij mund t’iu shërbejë organeve kompetente për marrjen e vendimeve rreth çështjeve kontestuese nga ndeshja në të cilën kishtë vërë super-kontrolla.

Neni 22

- 1 Të gjitha ndeshjet e garave të përhershme dhe ndeshjet publike të klubeve si dhe ndeshjet e seleksioneve të ndryshme të përbëra nga lojtarët e klubeve të ndryshme, mund t’i drejtojë vetëm referi aktiv i futbollit, anëtar i Shoqatës së Referëve të Kosovës.

- 2 Referi i futbollit nuk mund të paraqitet si lojtar për klubin i cili garon në Ligën në të cilën referon ai. Referët të cilët janë lojtarë aktiv në kohën e dënimit me ndalim të gjykitimit-referimit nuk mund të paraqiten në ndeshjet publike si lojtarë, gjegjësisht në kohën e dënimit me ndalesë të ndeshjeve si lojtarë, nuk mund të referojë në ndeshjet publike.
- 3 Referët e dënuar nga organet e Federatës dhe organet gjyqësore për vepër penale nuk mund të referojnë pa e parfunduar dënimin dhe të kryejnë funksion në asnjë garë të organizuar nga FFK-ja, as në Liga të Seniorëve, të femrave e as në futball apo për grupmosha të reja.
- 4 Të drejtat dhe obligimet e referëve përcaktohen me Rregulloret e Lojës së Futbollit dhe ato të Refereve.

Neni 23

- 1 Nëse referi i caktuar nuk vjen në ndeshje të garës së përhershme, atë ndeshje do ta drejtojë Referi i Katërt apo Referi i Parë Ndhimës. Po qe se nuk ka ardhur Referi i Parë Ndhimës ndeshjen do ta drejtojë Referi i Dytë Ndhimës.
- 2 Nëse në ndeshje nuk vjen referi kryesor e as referët e caktuar ndihmës, klubet do të merren vesh ndërmjet vete që ndeshjen ta drejtojë ndonjëri prej referëve të pranishëm (por ai duhet të jetë nga lista e referëve të rangut përkatës).
- 3 Nëse marrëveshja nuk mund të arrihet, atëherë delegati do të vendosë se cili prej referëve të pranishëm do ta drejtojë ndeshjen.
- 4 Marrëveshja mbi zgjedhjen e referit duhet të vërtetohet me shkrim para fillimit të ndeshjes. Procesverbalin mbi marrëveshjen e nënshkruajnë përfaqësuesit e klubeve dhe delegati.
- 5 Ky procesverbal i bashkangjitet raportit të ndeshjes.
- 6 Nëse nuk përpilohet procesverbalin për këtë çështje, atëherë delegati do të kërkojë prej përfaqësuesve të klubeve që të vërtetojnë në raport marrëveshjen e arritur me referin.
- 7 Nëse klubet nuk kanë arritur marrëveshjen mbi zgjedhjen e referit, por delegati e ka caktuar vetë, kjo rrethanë duhet të konstatohet në protokollin e ndeshjes.
- 8 Kur në ndeshje nuk vjen referi kryesor, referët ndihmës e as delegati i ndeshjes, atëherë mund të zhvillohet një ndeshje miqësore, nëse me rregulloren e garave nuk parashihet ndryshe.
- 9 Nëse në ndeshje vjen referi kryesor por nuk vjen njëri prej referëve ndihmës apo të dy referët ndihmës, atëherë do të veprohet në mënyrë analoge si në situatën e paraparë me dispozitat e pikës 2 dhe 3 të këtij neni.
- 10 Nëse gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes referit kryesor i keqësohet gjendja shëndetësore ose paraqiten shkaqe të tjera për të cilat nuk mund të vazhdojë drejtimin e ndeshjes, detyrën e tij e merr referi i katër apo referi i parë ndihmës, ndërsa detyrën e referit ndihmës e merr njëri prej referëve të pranishëm të cilin e cakton ai. Nëse e njëjta gjë i ndodh referit ndihmës, atëherë do të veprohet sipas dispozitave të pikës 7 të këtij neni.
- 11 Prej momentit të delegimit referët nuk kanë të drejtë të komunikojnë më zyrtarët e klubeve. Cdo komunikim i referëve me zyrtarët e klubeve do të konsiderohet tendencë për marrëveshje apo mitosje dhe për këtë do të iniciohet procedurë disiplinore ndaj personave që kanë komunikuar.
- 12 Përjashtim bënë komunikimi me personin e autorizuar të klubit gjatë zhvillimit të ndeshjes e që ka të bëjë me organizimin e ndeshjes.

- 13 Referët janë të obliguar të paraqesin çdo zyrtar të klubeve apo persona të tjerë të cilët kanë kontaktuar apo kanë orvatur të kontaktojnë pas delegimit për ndeshje. Në të kundërtën do të kenë pasoja të parapara me Rregulloren Disiplinore.

TRAJNERËT

Neni 24

- 1 Trajneri mund të kryejë detyrën e vet në ndeshje publike vetëm nëse posedon leje për punën në klubin e caktuar, përkatësisht licencën e lëshuar nga organi kompetent i FFK-së, në pajtim me dispozitat e akteve gjegjëse normative.
- 2 Nëse Delegati konstatomn se trajneri nuk ka leje për punë të dhënë në pajtim me pikën 1 të këtij nenin, atij nuk do t'i lejojë hyrjen-uljen në bankinë , respektivisht qëndrimin në pjesën e rrethuar të stadiumit të paraparë për lojtarë rezervë dhe persona zyrtarë.

Neni 25

- 1 Trajnerët të cilët marrin paga nuk mund të paraqiten në ndeshjet publike si lojtarë. Kjo vlen për Superligë dhe për Ligën e Parë.
- 2 Me këtë nocion nënkuptohen personat të cilët paguhen për punën e tyre dhe janë të evidentuar në FFK si trajner i ekipit gjegjës.
- 3 Kundër klubeve që nuk i përmbahen këtij kriteri, do të hapet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së.

PËRFAQËSUESI I KLUBIT DHE PERSONI PËRGJEGJËS PËR SIGURI

Neni 26

- 1 Secili klub duhet të caktojë personat të cilët do ta përfaqësojnë klubin si:
 - a) Organizator i ndeshjes (Match Manager)
 - b) Personi përgjegjës për siguri, dhe
 - c) Personi për media.
- 2 Në ndeshjet e garave të përhershme, përfaqësuesi i klubit duhet të jetë i licencuar në listën e lojtarëve dhe zyrtarëve nga FFK nga fillimi i sezonës.
- 3 Përfaqësuesit e klubit në ndeshjet e garave të përhershme, përveç të tjerave kanë edhe këto të drejta dhe detyra:
 - a) Që t'i paraqiten delegatit dhe referëve më së voni 75 minuta para fillimit të ndeshjes.
 - b) Që menjëherë pas paraqitjes së delegatit t'ia dorëzojë (kumptojë) formacionin e ekipit dhe dorëzojë ID-të e lojtarëve të cilët do të zhvillojnë ndeshjen si dhe të atyre rezervë.
 - c) Të marrë pjesë në vërtetimin e identitetit të lojtarëve dhe të verifikojë rregullsinë e ID-ve futbolistike dhe duhet të ketë kartën e identifikimit nga klubi (bexhin).
 - d) Që para fillimit të ndeshjes ta vërtetojë, përpilojë me shkrim dhe dorëzojë tëk delegati formacionin e ekipit të vet, ndërsa pas përfundimit të ndeshjes të marrë pjesë në përpilimin e protokollit dhe të paraqesë vërejtjet eventuale të parapara me rregulloren e garave.

- e) Organizatori i ndeshjes i klubit vendas është i obliguar që gjatë kohës sa zgjat ndeshja të jetë në afërsi të delegatit në mënyrë që t'i ofrojë ndihmë në eliminimin e dobësive eventuale të cilat paraqesin pengesa për zhvillimin normal të ndeshjes, dhe
 - f) Të kryejë punë të tjera që parashihen me akte të përgjithshme dhe Rregulloren e Garave.
- 4 Përgjegjësi për siguri i klubit duhet të jetë person i licencuar me kualifikim përkatës të sigurisë sipas ligjeve të vendit. Në ndeshjet e garave të përhershme, përveç të tjerave, ka edhe këto të drejta dhe detyra:
- a) Që të jetë në stadium së paku 90 minuta para fillimit të lojës, t'i paraqitet delegatit dhe referit posa ata të arrijnë në stadium dhe nëse është nevoja edhe jashtë stadiumit, para fillimit të ndeshjes dhe pas përfundimit të saj.
 - b) Që menjëherë pas paraqitjes së delegatit t'ia paraqes atij gjendjen e sigurisë dhe masat e marra të sigurisë.
 - c) Që para fillimit të ndeshjes të mos lejojë persona të paautorizuar të qëndrojnë në objekte të stadiumit dhe në fushë. Përgjegjësi për siguri i klubit vendas është i obliguar që gjatë kohës sa zgjat ndeshja të jetë në afërsi të delegatit, në mënyrë që t'i ofrojë ndihmë në eliminimin e dobësive eventuale të cilat paraqesin pengesa për zhvillimin normal të ndeshjes dhe pas përfundimit të ndeshjes të sigurojë përcjelljen e personave zyrtarë dhe të ekipeve pjesëmarrëse në gara.
 - d) Të kryejë punë të tjera që parashihen me akte të përgjithshme dhe rregullore të garave.
 - e) Përgjegjësi për siguri duhet të ketë shenjën identifikuese ose së paku një jelek ngjyrë dalluese.

X ORGANIZIMI I NDESHJEVE

Neni 27

- 1 Klubi nikoqir është i obliguar që secilën ndeshje ta paralajmërojë me shkrim apo të ketë kontratë të nënshkruar me organin për siguri publike (Policinë e Kosovës).
- 2 Më së voni 3 ditë para zhvillimit të ndeshjes të kërkojë numër të nevojshëm të pjesëtarëve të sigurimit.
- 3 Të ketë lejen e organit të sigurisë publike, Policisë së Kosovës, për organizimin e ndeshjes apo vërtetimin mbi pranimin e paraqitjes me shkrim, klubi nikoqir ia dorezon delegatit të ndeshjes para fillimit të saj, e kjo së bashku me raport i përcillet Federatës gjegjësisht Komisionit të Garave.
- 4 Të caktojë përfaqësuesin zyrtar për siguri të licencuar dhe i cili duhet të kujdeset për sigurinë gjatë ndeshjes dhe pas saj.
- 5 Emrin e përfaqësuesit zyrtar dhe përfaqësuesit zyrtar për siguri, klubi nikoqir ia dorëzon delegatit të ndeshjes i cili ia bashkangjet raportit të vet i cili i dërgohet Komisionit të Garave.
- 6 Përfaqësuesi zyrtar është përgjegjës për organizimin e përgjithshëm të ndeshjes, gjegjësisht mundësimin e kushteve për kryerjen e detyrës, delegatit të ndeshjes.
- 7 Zyrtari përgjegjës për siguri duhet të bëjë sigurimin e referëve, delegatit, mysafirëve, klubit të vet dhe organeve të tjera zyrtare, para, gjatë dhe pas ndeshjes.

- 8 Që gjatë kohës së ndeshjes ta sigurojë automjetin e ndihmës së parë (obligative për ekipet e Superligës dhe Ligës së Parë) apo ndonjë automjet tjetër i dedikuar për ndihmë të shpejtë.
- 9 Që gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes tek shikuesit, të ndalojë shitjen e pijeve alkoolike si dhe pijeve të tjera joalkoolike me ambalazhë qelqi, plastike apo metali (nëse ndalohet me ligjet e vendit).
- 10 Të bëjë regjistrimin e tabelave të automjetit kujdestar, me emër dhe mbiemër të mjekut, e kjo t'i dorëzohet delegatit të ndeshjes.
- 11 Pas përfundimit të ndeshjes të raportojë tek delegati për incidentet eventuale të ndodhura para, gjatë dhe pas zhvillimit të ndeshjes.
- 12 Të sigurojë mbledhësit e topave (të rinj), ndërsa numri i tyre duhet të jetë minimum 8- maksimum 12 me veshje sportive, të cilat dallohen nga ato të lojtarëve të cilët luajnë në fushë.
- 13 Të mos lejojë që në lokalet zyrtare të futen persona të cilët nuk kanë të drejtë.
- 14 Të sigurojë së paku 3 topa për lojë, të përshtatshëm dhe kualitativ.
- 15 Që përfaqësuesve zyrtarë, trajnerëve, mjekut, fizioterapeutit, t'iu sigurojë emblemat (shenjat) që do t'i bartin gjatë ndeshjes.
- 16 Ta sigurojë përcjelljen pa pengesa të ndeshjes, klubit mysafir dhe organeve zyrtare.
- 17 T'i përfillë vendimet e tjera, të cilat, në raste të veçanta, sipas nevojës, i merr Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Ekipi nikoqir është i obliguar ta bëjë sigurimin e fushës gjatë tërë kohës së zhvillimit të ndeshjes, përmes pranisë së pjesëtarëve të stjuardëve – kompanisë së sigurimit, të Policisë së Republikës së Kosovës.
- 18 Në rastet kur ndeshja nuk zhvillohet për shkak se ekipi nikoqir nuk ka siguruar praninë e pjesëtarëve të forcave të theksuara në pikën paraprake, atëherë: Komisioni i Garave i rangut përkatës do të caktojë terminin tjetër për zhvillimin e kësaj ndeshjeje të pafilluar, në pajtim me dispozitat e akteve normative të FFK-së, ndërsa të gjitha shpenzimet e përsëritura për personat zyrtarë si dhe shpenzimet e ekipit mysafir (udhëtimi dhe një racion-shujtë) i bart ekipi nikoqir.
- 19 Nëse kjo ndeshje nuk zhvillohet as në terminin e përsëritur, caktuar nga Komisioni i Garave për arsye të njëjtë, atëherë ekipi nikoqir – organizatori i ndeshjes, të njëjtën e humb me rezultatin zyrtar – Parforfe (3:0)
- 20 Në të gjitha ndeshjet e futbollit, brenda rrethojës së fushës, në vendet përkatëse, mund të gjenden personat me sa vijon:
 - a) Kryetrajneri për Superligë, duhet të ketë së paku Licencën A të UEFA-s, ndërsa për Ligën e Parë së paku Licencën B të UEFA-s (deri në vendimin tjetër të KE të FFK-së), në të kundërtën trajneri i palicencuar largohet nga bankina, ndërsa klubi dënohet me 500 Euro.
 - b) Më së shumti 7 lojtarë rezervistë, dhe
 - c) 7 zyrtarë të klubit, duke përfshirë: 3 trajnerë, 1 mjek, 1 fizioterapeut dhe 2 zyrtarë të tjerë të shënuar në raportin e ndeshjes.
- 21 Në rast se dikush nga personat e lartpërmendur nga pika 20 nuk e ka përgatitjen përkatëse, emblemën/shenjën apo ID-në, delegati i ndeshjes do të kërkojë nga përfaqësuesi zyrtar apo përgjegjësi për siguri i klubit nikoqir, që personat e tillë të largohen nga fusha. Në rast se kërkesa e delegatit nuk përfillet, ndeshje nuk mund të fillojë, apo, nëse ka filluar, nuk mund të vazhdojë.

RAPORTI I NDESHJES

Neni 28

- 1 Për çdo ndeshje publike përpilohet raporti zyrtar.
- 2 Raportin për ndeshje të garave të përhershme e formulon delegati, ndërsa në mungesë të tij e përpilon referi.
- 3 Raporti i ndeshjes shkruhet nga ana e delegatit, me kompjuter dhe dërgohet në mënyrë digjitale në FFK.
- 4 Delegati i ndeshjes i komunikon verbalisht përgjegjësve të të dy klubeve përmbajtjen e raportit (në rast të ndonjë incidenti).
- 5 Delegati përpilon edhe raportin e Fair Play si dhe raportin plotësues në rast nevojë (incidenti) pas konsultimit me referët.
- 6 Raporti zyrtar duhet të përmbajë këto elemente: rangun e garave të ndeshjes, datën, vendin dhe kohën e zhvillimit të ndeshjes, terrenin (stadiumin), emërtimet e ekipeve, përbërjen e ekipeve, emrat e personave zyrtarë, rezultatin e arritur përfundimtar dhe atë të pjesës së parë, zëvendësimet e bëra, emrat e lojtarëve të ndëshkuar me vërejtje publike apo të përjashtuar, emrat e lojtarëve golashënues me minutat e shënimeve, vlerësimin e delegatit dhe përfaqësuesve të dy klubeve rreth ndeshjes, Raportin e Referit mbi masat disiplinore të shqiptuara dhe shkaqet, deklaratën mbi incidentet dhe trazirat, paralajmërimin e ankesës me shkaqet e saj, etj.

Neni 29

- 1 Lojtarët dhe personat e larguar (ndëshkuar) prej referit janë të detyruar ta lëshojnë menjëherë fushën dhe të shkojnë në vendin e posaçëm ose në tribunë, përndryshe bëjnë kundërvajtje disiplinore dhe ndëshkohen sipas Rregullores Disiplinore.
- 2 I njëjti rregull vlen edhe për personat zyrtarë të klubit që gjenden në bankinë.
- 3 Për të gjitha këto raste të lartcekura referi është i detyruar t'i shënojë në raportin e tij pas ndeshjes dhe t'i dorëzojë tek delegati.

Neni 30

Raporti i ndeshjes së garave të përhershme përpilohet dhe plotësohet në zyrë të delegatit ku duhet të ketë qasje në internet, kompjuter. Ky raport duhet të plotësohet pas përfundimit të ndeshjes ose më së largu deri ditën e nesërme në ora 08:00.

Neni 31

- 1 Raporti i ndeshjes është dokument zyrtar, andaj të dhënat e shënuara në të konsiderohen të sakta gjithnjë deri sa të mos vërtetohet e kundërta.
- 2 Nëse në të dhënat e shënuara në Raport konstatohet ndonjë gabim, organi kompetent që udhëheq me gara do të bëjë përmirësimin ashtu që raporti i ndeshjes t'i përgjigjet gjendjes faktike.

- 3 Përmirësimi i gabimeve në raport kryhet sipas detyrës zyrtare, në përputhje me të dhënat nga raportet plotësuese të referit, referit ndihmës dhe delegatit të ndeshjes, si dhe kërkesën me shkrim të klubeve pjesëmarrëse në ndeshje.
- 4 Edhe klubi pjesëmarrës në ndeshje dhe palët e tjera të interesuara mund të paraqesin kërkesën për përmirësimin e të dhënës së shënuar gabimisht në raport, përmes emailit apo me letër rekomanduese, më së voni në afat 24 orësh nga përfundimi i ndeshjes. Një kopje të kërkesës në afat të njëjtë i dërgohet edhe klubit tjetër pjesëmarrës (respektivisht klubeve pjesëmarrëse) në ndeshje.
- 5 Nëse eventualisht ndodh që në raportin zyrtar të jenë bërë lëshime dhe të cilat Komisioni i Garave i cilëson si të paqëllimshme dhe nuk prekin në substancën e raportit, atëherë ato mund të përmirësohen brenda afatit të lejuar.

TERRENI FUTBOLLISTIK

Neni 32

- 1 Secili terren futbollistik në të cilin zhvillohen ndeshjet publike duhet të jetë i regjistruar dhe i pranuar nga ana e organit kompetent, Komisionit për Pranimin e Terreneve, i cili edhe e bën regjistrimin e terrenit për ndeshjet e rangut garues.
- 2 Regjistrimi i terrenit të futbollit bëhet në bazë të raportit të Komisionit të Posaçëm për Kontrollimin dhe Pranimin e Terreneve, të cilin e cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.
- 3 Komisionin e përbëjnë tre anëtarëm njëri prej të cilëve duhet të jetë refer apo ish-refer.
- 4 Komisioni përpilon procesverbalin mbi kontrollimin e bërë të terrenit dhe për këtë lëshon Vendim.
- 5 Komisioni për inspektimin e fushave, pas përfundimit të Kampionatit bënë shiqimin e të gjitha stadiumeve dhe vërejtjet ua paraqet zyrtarëve të klubeve të cilët janë të obliguar që t'i eliminojnë ato deri në kohën kur Komisioni apo KE u jep afat për përmbushje të tyre.
- 6 Në rast se Komisioni konstaton se përkundër vërejtjeve klubi nuk i ka eliminuar në tërësi vërejtjet që Komisioni i ka parashtruar klubit por ata janë duke punuar në vetimin e tyre, atëherë Komisioni mund të bëjë sërish kontrollimin pas një javë apo në afatin të cilin e cakton vetë Komisioni. Shpenzimet e Komisioni do t'i faturohen klubit i cili nuk i ka përmbushur kriteret me kohë.
- 7 Kur Komisioni definitivisht nuk e pranon një terren sportiv për garat gjegjëse, atëherë klubet kanë të drejtë të paraqesin kërkesë të sërishme për inspektim por jo në afat më të shkurtër se 30 ditë nga dita e inspektimit të fundit. Shpenzimet i merr persipër klubi aplikues.
- 8 Ankesat për parregullsinë në dimensionet e terrenit, shënimin e vijave në të, madhësinë e portave, topit të lojës, etj. do të refuzohen, nëse klubi i cili e ushtron atë (ankesën), para fillimit të ndeshjes nuk i ka bërë kundështim me shkrim referit për gjërat që theksohen në ankesë.
- 9 Nëse konstatohet se ekipi ka ndryshuar dimensionet e fushës dhe portës e të cilat nuk i përgjigjen rregullave të lojës së futbollit dhe kategorisë ku klubi bën gara, ndaj klubit do të inicohet procedurë disiplinore.
- 10 Nëse ka vëretje në dimensionet e fushës, portës dhe topit, kontrollori dhe referët duhet me shkrim të cekin para fillimit të ndeshjes gjendjen faktike pas matjeve që kanë bërë. Nëse klubi nikoqir pas kërkesës së delegatit dhe referët nuk i përmirëson vërejtjet e gjetura brenda 15 minutave nga koha e fillimit të lojës, atëherë loja nuk do të zhvillohet dhe klubi nikoqir do ta humbë atë me rezultat zyrtar.

Neni 33

- 1 Terrenet në të cilat zhvillohen ndeshjet e garave zyrtare të Kosovës, duhet të jenë të pranuar nga KE-ja, në bazë të kritereve për infrastrukturë.
- 2 Klubi futbollistik duhet të vërtetojë së në mënyrë ligjore ka të drejtën në shfrytëzimin e stadiumit (është pronar) ose se ka kontratë me shkrim me pronarin e stadiumit në fillim të sezonës garuese.
- 3 Sipas UEFA-s proporcionet e fushës duhet të jenë standard: standard për ndeshje ndërkombëtare: 105m x 68 m ose min.100m x 64m (UEFA parasheh proporcionet 120m 80m). KE ka paraparë që për Superligë proporcionet e fushës duhet të jenë min 100m x 60m, max.120m x 80m.
- 4 Për Ligën e Dytë dhe më poshtë 90m x 60m dhe max 120m x 80 m.
- 5 Kriteret e UEFA-s dhe FIFA-s parashohin edhe kritere të tjera varësisht nga niveli i pjesëmarrjes në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.
- 6 Komiteti Ekzekutiv në pajtim me aktet normative të FFK-së do të caktojë minimumin e standardeve për terrenet në të cilat zhvillohen ndeshjet e rangut të caktuar të garave.
- 7 Të gjitha klubet obligativisht duhet t'i kenë fushat e veta apo të huazuara, në bazë të marrëveshjes, për çdo vit garues (të cilat duhet të mirëmbahen, të përgatiten për ndeshje, të pastrohen nga të reshurat atmosferike dhe të krijojnë kushtet për zhvillimin e ndeshjes së caktuar). Mosndërmarrja e masave për përgatitjen e terrenit për ndeshje (pastrimit, vizatimi, etj.) sanksionon ekipin nikoqir me humbjen e ndeshjes me rezultat zyrtar.
- 8 Kriteret e UEFA-s parashohin që çdo ekipi i lincencuar duhet të ketë edhe terrenet ndihmëse dhe objektet përcjellëse për ushtrime. Elementet kryesore në të cilat mbështetet inspektimi nga Komisioni i FFK-së janë:
 - a) Shtyllat dhe këndet në përmasa standarde;
 - b) Fusha e mbuluar me bar;
 - c) Bankinat për vendas, mysafirë dhe personat zyrtarë duhet të jenë sa më afër zveshtoreve;
 - d) Rrethoja e fushës;
 - e) Zveshtorja për ekipin mysafir;
 - f) Zveshtorja për ekipin vendas;
 - g) Zveshtorja për referë;
 - h) Zyra për personat zyrtarë;
 - i) Banjo dhe toalet për ekipin mysafir;
 - j) Banjo dhe toalet për ekipin vendas;
 - k) Hapësira e caktuar për media;
 - l) Fusha e lojës duhet të jetë e shënuar me vija të cilat nuk duhet të jenë më të gjera se 12cm. Radiusi (rrethi) i vijës së rrumbullakësuar në qendër duhet të jetë 9.15cm;
 - m) Shtyllat e golit (10-12cm) duhet të vendosen në mes të qendrës së vijës së fundit dhe duhet të jetë e gjerë 7.32m dhe e gjatë 2.44m. Ato duhet të jenë të përforcuara dhe të siguruara mirë;
 - n) Vija e parë prej portës (trashësia 10-12cm) për në qendër duhet të jetë 5.5m ndërsa e dyta 16.5m;
 - o) Pika e penalltisë duhet të shënohet në largësi prej 11m dhe në qendër;
 - p) Flamuri i kornierit duhet të vendoset në të katër anët me lartësi prej 1.5m ndërsa radiusi i rrethit të kornierit duhet të jetë 1 metër.

- q) Flamujt preferohet të vendosen edhe në të dy skajet e qendrës së fushës mirëpo gjatësia duhet të jetë 1 metër.

VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË SË TERRENIT PËR LOJË

Neni 34

- 1 Ndeshjet mund të zhvillohen vetëm në terrenin i cili është i përshtatshëm për lojë dhe i pranuar për atë rang të garave.
- 2 Ekipi nikoqir është i obliguar që ta përgatisë terrenin ashtu që të jetë i përshtatshëm për lojë, duke e përgatitur fushën, shënuar vijat, siguruar rrjetat për portë si dhe flamujt anësorë.
- 3 Vlerësimi i përshtatshmërisë së terrenit duhet të bëhet nga referi dhe delegati.
- 4 A është terreni i përshtatshëm për lojë apo jo, për shkak të ndikimit të kushteve atmosferike dhe shkaqeve të tjera që radhiten në fuqi madhore, vendos referi i cili është i caktuar ta drejtojë ndeshjen.
- 5 Referi nuk do ta fillojë ndeshjen nëse:
 - a) Terreni për lojë nuk është vizatuar shiqueshëm dhe drejt, si dhe rekuizitat elementare (rrjetat, portat, flamujt, etj.) të terrenit nuk kanë qenë të vendosura drejt dhe në mënyrë të rregullt;
 - b) Terreni për lojë është i mbuluar me baltë dhe ujë të cilat e pengojnë lëvizjen e lojtarëve dhe topit;
 - c) Terreni për lojë është i ngrirë dhe ekziston mundësia e lendimit të pjesëmarrësve të lojës;
 - d) Terreni për lojë është i mbuluar me borë, lartësia e së cilës pamundëson lëvizjen e lojtarëve, topit dhe referëve;
- 6 Për shkak të mjegullës, shiut, furtunës, nuk shihen portat nga vija e mesit të fushës, referi dhe kontrollori janë të obliguar që në raport të cekin shkakun e marrjes së vendimit për ndërprerje.
- 7 Në rast të kohës së ftohtë -15 gradë celsius, ndeshja mund të mos zhvillohet ose të zhvillohet vetëm me pëlqimin me shkrim të të dy ekipeve.
- 8 Në rast të kohës së nxehtë +32 gradë celsius, ekipet mund të kërkojnë pushimin gjatë lojës në pjesën e parë 25 minuta nga fillimi i lojës dhe pas 25 minutave të fillimit të pjesës së dytë. Pushimi zgjat 1 minutë.

LOJTARËT: NUMRI MË I VOGËL DHE ZËVENDËSIMET

Neni 35

- 1 Ndeshja nuk mund të fillojë nëse njëri prej ekipeve ka më pak se 7 lojtarë.
- 2 Lojtarët të cilët nuk fillojnë ndeshjen nuk kanë mundësi të yjnë në lojë deri në fund të ndeshjes, por që paraprakisht janë shënuar në Raport si lojtar apo rezervë.

Neni 36

- 1 Nëse një ekip gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes mbetet me më pak se 7 lojtarë, referi është i obliguar që ndeshjen ta ndërpresë po qe se ekipi nuk është në gjendje që brenda 5 minutave të sigurojë numrin e nevojshëm të lojtarëve.

- 2 Nëse në afat prej 30 minutash nga koha e caktuar për fillimin e ndeshjes së garave të përhershme, nuk paraqitet njëri ekip me numër të mjaftueshëm të lojtarëve, referi do t'ia komunikojë kapitenit të ekipit i cili është paraqitur, se ndeshja nuk do të zhvillohet dhe atë do ta konstatojë në Raportin e Ndeshjes.
- 3 Organi i cili udhëheq me gara ndeshjen do ta regjistrojë me rezultat zyrtar 3:0 (parforfe) nëse konstaton se mosardhja e ekipit në ndeshje është e paarsyeshme.

Neni 37

- 1 Në ndeshjet kampionale dhe për Kupë, gjatë ndeshjes në njërin ekip mund të zëvendësohen më së shumti katër (4) lojtarë, ku lojtari i 4-t duhet të zëvendësohet pas vazhdimëve, dy herë nga 15 minuta, duke respektuar disozitat e FIFA-s.
- 2 Kurse në ndeshjet e U19, U17, U15, në njërin ekip mund të zëvendësohen më së shumti 5 lojtarë.
- 3 Ndwrsa zëvendësimet pwr U13, U11, U9 mund të kryhen vetëm me lojtarë të cilët para ndeshjes janë evidencuar në raport, e ata mund të jenë më së shumti 7.

XI AFATI KALIMTAR I LOJTARËVE

Neni 38

- 1 Afati kalimtar i lojtarëve të cilët dëshirojnë të kalojnë nga një klub në klubin tjetër të Kosovës është: në muajin janar (afati kalimtar dimëror) dhe nga fillimi i korrikut deri në fund të gushtit (afati i rregullt kalimtar veror). Datat e sakta i cakton Komiteti Ekzekutiv i FFK-se, me vendim të posaçëm, që e merr në kohën e duhur, bazuar në afatet e sugjeruara dhe ato obligative të FIFA-s.
- 2 Një ekip i Superligës mund t'i regjistrojë 8 lojtarë të huaj (por te drejtë aktivizimi kanë vetëm 6) gjatë afateve kalimtare. Ndërkaq, në një ekip të Ligës së Parë munden të regjistrohen dhe aktivizohen maksimumi 4 lojtarë jo shtetas të Kosovës. Lojtarët shtetas të Shqipërisë nuk konsiderohen të huaj sipas kësaj Rregulloreje.
- 3 Gjatë zhvillimit të lojës ekipi mund ti ketë në protokol dhe t'i aktivizojë maksimumi 6 lojtarë të huaj (Superliga). Në listën e lojtarëve e cila i dorëzohet delegatit përpara lojës, ekipi mund të paraqesë në 18-she maksimumi 6 lojtarë, duke përfshirë edhe 11-shen e parë.
- 4 Në Ligën e Parë, nëprotokol mund te hyjnë vetëm 4 lojtarë të huaj dhe mund të aktivizohen maksimumi 4 lojtarë jo shtetas të Kosovës. Lojtarët shtetas të Shqipërisë nuk konsiderohen të huaj sipas kësaj Rregulloreje.
- 5 Ekipet e Ligës të 2-të dhe Lidhjeve Rajonale, ekipet U19, U17, U15, U13, U11 munden ti regjistrojnë dhe aktivizojnë maksimumi. 2 lojtarë të huaj.

XII FANELAT

Neni 39

- 1 Ekipet në një ndeshje nuk mund të luajnë me fanela të ngjyrevë të njëjta apo të ngjashme. Kompetent për vlerësimin e këtij elementi është referi kryesor (pas konsultimit me anësorët) i cili edhe e merr vendimin definitiv lidhur me këtë.

- 2 Nëse ekipet fanelat tradicionale i kanë me ngjyrë të njëjtë apo të ngjashme, atëherë ekipi mysafir është i obliguar që të ndërrojë fanelat, në të kundërtën, nëse ndeshje nuk do të mund të zhvillohet për këtë arsye, ajo do të regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0 në favor të ekipit nikoqir.
- 3 Para fillimit të Kampionatit, me rastin e licencimit në FFK, ekipet janë të obliguara të njoftojnë organin që udhëheq me gara për ngjyrat (tradi.dhe rezervë) me të cilat do të luajë në atë kampionat.
- 4 Më së voni 15 ditë para fillimit të vitit garues, organi gjegjës i referëve të futbollit të FFK-së është i obliguar të shpallë ngjyrën rezervë të fanelave të referëve. Ngjyra e paraqitur e fanelave të klubeve qartas duhet të ndryshojë nga ngjyra zyrtare e fanelave të referëve.
- 5 Referët janë të obliguar që në ndeshje të disponojnë me fanelat rezervë.

Neni 40

- 1 Gjatë kohës së zhvillimit të ndeshjes, lojtarët në pjesën e prapme (shpinë) të fanelave të veta duhet të kenë numrat e dukshëm të madhësisë së caktuar me dispozita.
- 2 Numrat në fanela duhet të përputhen me numrat në regjistrin e lojtarëve të shënuar me protokollin e ndeshjes.
- 3 Dispozitat të cilat më për së afërmi do të rregullojnë ngjyrën e ndërresave (fanelave, shorceve, mbashjes), numrave (madhësisë) etj. do të caktohen me akt të posaçëm normativ të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së.

XIII ORGANIZIMI I NDESHJES

Neni 41

- 1 Organizimin e ngjarjeve sportive e bën Federata e Futbollit e Kosovës.
- 2 Organizimin e ngjarjeve sportive mund ta bëjnë klubet sportive, organizatat e sportistëve, shoqatat e sportistëve dhe personat fizikë apo juridikë që paraprakisht kanë bërë marrëveshje me Federatën e Futbollit të Kosovës.
- 3 Organizatori i ngjarjeve sportive është i obliguar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e ngjarjes sportive, e ne veçanti duhet të kujdeset për masat parandaluese të shfaqjes së dhunës dhe sjelljeve të palejuara.
- 4 Të gjithë organizatorët e ngjarjeve sportive në futboll, përpos që implementojnë dispozitat obligative nga aktet normative të FFK-së, i nënshtrohen edhe Ligjit mbi Parandalimin e dhunës dhe dukurive negative në sport e sidomos kapitujve:
 - a) Dhuna, sjelljet e palejuara, kurdisjet dhe dukuritë negative në ngjarjet sportive;
 - b) Masat organizative;
 - c) Masat preventive;
 - d) Obligimet e organizatorit në ngjarjet sportive me rrezikshmëri të lartë;
 - e) Obligimet e organizatorit për sigurimin e kushteve teknike;
 - f) Masat të cilat i ndërmarrin organet shtetërore kompetente;
 - g) Bartja e shpenzimeve lidhur me masat e shqiptuara;
 - h) Masat disiplinore dhe direktivat;
 - i) Masat disiplinore kundër anëtarëve dhe klubeve, etj.

Neni 42

- 1 Dispozitat mbi organizimin e ndeshjes dhe rendin në stadion gjatë zhvillimit të ndeshjës caktohen me këtë Rregullore të garave të lojës së futbollit, Ligjit mbi parandalimin e dukurive negative në sport, Rregullorës mbi infrastrukturën e stadimeve FFK (UEFA), dhe Manualin e delegatit.
- 2 Organizatori i ndeshjes është i obliguar të organizojë zhvillimin e saj në pajtim me dispozitat e kesaj rregullore.
- 3 Për organizimin e ndeshjes përgjegjës është ekipi nikoqir.

Neni 43

Organizatori i ndeshjes është klubi i parë (nikoqiri) i shënuar në orarin e ndeshjeve. Detyrat e organizatorit të ndeshjes janë të pershkrjuara sipas Ligjit mbi parandalimin e dukurive negative në ngjarje sportive dhe Rregulloren e Garave.

- 1 të sigurojë shërbimin e nevojshëm mjekësor,
- 2 të sigurojë shërbimin gjegjës të sigurisë (Policinë e Kosovës),
- 3 që ekipit mysafir t'i ofrojë dhe sigurojë mikpritje dhe lokal për qëndrim para dhe pas përfundimit të ndeshjes një gjë e tillë është nevojshme , që personave zyrtar (nëse ata nuk jetojnë në vendin ku zhvillohet ndeshja), me kërkesën e tyre t'iu sigurojë lokal qëndrimi, ashtu siç parasheh rregullorja e garave .
- 4 të ndër marrë të gjitha masat për organizimin dhe sigurimin e ndeshjes. Me rregullorën e garave mund të rregullohet më për së afërmi mënyra e kryerjes së obligimeve nga alinea e mëparëshme si dhe obligimet tjera të organizatorit të ndeshjes.

XIV NDESHJET PUBLIKE

Neni 44

- 1 Me ndeshje publike nënkuptohen të gjitha ndeshjet e garave të përhershme si dhe ndeshjet miqësore dhe turnetë që i organizojnë klubet, organizatat sportive etj.
- 2 Ndishjet miqësore publike dhe turnetë organizohen sipas dispozitave të cilat vlejné për gara të përhershme dhe dispozitave të posaçme që parashihen me këtë rregullore. Përsona që bëjnë lëshime dhe kundërvajtje eventuale në ndeshje publike, mirren në përgjegjësi sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së.
- 3 Ndishjet përgatitore nuk konsiderohen si ndeshje publike. Në këto ndeshje nuk vlejné kufizimet lidhur me të drejtën e lojës dhe ndalesën e lojës, me marrjen pjesë të lojtarëve nga klubet tjera, me numrin e ndërrimeve që mund të bëhen në ndeshje etj. Në këto ndeshje nuk mbahet raporti dhe nuk i paraqitet raporti organit kompetent të futbollit, madje edhe rastet kur ato i drejton Referi i papërvojë.

Neni 45

- 1 Në ndeshjet e garave të përhershme mund të luajnë vetem lojtarët të cilët kanë fituar të drejtën e lojës për klubin e vet dhe para ndeshjes janë të shënuar në raport si lojtarë apo rezervë.

- 2 Gjithashtu në ndeshjet të caktuara publike mund të luajnë si mysafir edhe lojtarët e klubeve tjera sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

XV NDESHJET MIQËSORE DHE TURNETË

Neni 46

- 1 Çdo ndeshje miqësore duhet t'i paraqitet Komisionit kompetent. Paraqitja e ndeshjes si dhe kërkesa për Referë duhet të bëhet së paku 8 ditë para ndeshjes, ndërsa për raste të arësyeshme 48 orë para ndeshjes. Arësyeshmërinë e kërkesës e vlerëson organi kompetent. Klubi i cili nuk u përmbahet këtyre dispozitave, është përgjegjës sipas dispozitave të Rregullorës Dicipline të FFK-së.
- 2 Çdo klub duhet të ketë lejen e organit kompetent për organizimin e Turneut.
- 3 Lejen nga pika paraprake e jep Komiteti Ekzekutiv respektivisht organi që e autorizon ai, dhe atë:
- 4 për turne në të cilat merrë pjesë një apo më shumë klube të huaja dhe ekipet e Superligës, Ligës së I-rë, Ligës së II-të, lejen e jep Organet e FFK-së.
- 5 Për të gjitha turnetë tjera, duke i përfshirë edhe turnetë e klubeve të të gjitha rangjeve garuese, lejen e jep organi kompetent i cili udhëheq me gara.
- 6 Për turnetë tradicionale të futbollit vendos KE me vendim të posaçëm dhe vendos se a do t'a futë turneun e tillë në kalendarin zyrtar të garave dhe a do ta merr përsiper organizimin e tyre.
- 7 Kërkesën për lejimin e turneut duhet bërë më së voni 15 ditë, para ditës së paraparë për fillimin e turneut. Kërkesës duhet bashkangjitur edhe propozicionet e garave të turneut.
- 8 Për turne ndërkombëtare, klubi organizator, kërkesën për lejimin e turnesë duhet ta paraqesë së paku dy muaj e gjysmë para zhvillimit (fillimit) të turneut, kërkesës duhet bashkangjitur propozicionet e turneut dhe regjistrin e e pjesëmarrësve.

Neni 47

- 1 Për fillimin e ndeshjes ndërkombëtare në vend apo jashtë vendi duhet të ketë lejen e organit kompetent të futbollit.
- 2 Lejen nga pika 1 e këtij neni e jep Organet e FFK-së, respektivisht organi që udhëheq me rangun respektiv ku garon klubi, dhe atë:
- 3 Për ndeshjet e klubeve të Superligës, Ligës së parë dhe të dytë, lejen e jep Komisioni i Garave,
- 4 Për ndeshjet e klubeve tjera si dhe për ekipe të U-19, U-17, U-15, etj., pastaj për ndeshjet e klubeve të ligës së L.Rajonale, lejen e jep Komisioni i garave gjegjëse.
- 5 Nëse leja kërkohet për periudhën kur zhvillohen ndeshjet kampionale apo për kupë, ndërsa me ato gara udhëheqin organet tjera, atëherë klubi është i obliguar që më parë të merr pëlqimin nga organi kompetent i cili udhëheq me gara.
- 6 FFK me rregullore të veçantë më për së afërmi përcakton kushtet për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare. Në afat prej 8 ditëve nga dita e kthimit nga jashtë, klubi është i obliguar që organit i cili i ka dhënë lejen për shkuarje jashtë vendit, t'i paraqesë raport mbi qëndrimin jashtë vendit.

- 7 Nëse ndonjë lojtar është përjashtuar në ndeshjet jashtë vendi, klubi është i obliguar që në afat prej tri ditëve nga kthimi të paraqes raportin dhe deklaratën e përfaqësuesëve të klubit dhe lojtarëve të përjashtuar.

Neni 48

Lojtari i regjistruar në një klub mund të luajë si mysafir në ndeshje miqësore të klubit tjetër, vetëm nëse disponon lejen me shkrim të lëshuar nga klubi i vet.

Neni 49

- 1 Në turnetë ndërkombëtare dhe ndeshjet ndërkombëtare në klubet e vendit dhe të huaja, mund të luajnë si mysafirë lojtarët e klubeve tjera, por me pëlqimin e klubit të vet dhe lejen paraprake të organit kompetent të FFK-së.
- 2 Kundër lojtarit dhe klubit i cili nuk e respekton dispozitën e alinesë paraprake do të zhvillohet procedura dicitinore sipas dispozitave të FFK-së.

Neni 50

- 1 Në ndeshjet ndërkombëtare reprezentative në vend dhe jashtë vendit, jashtë suazave të FFK-së (si reprezentacionet e studentëve, shkollave, të mesme, sindikatave etj) mund të luajnë edhe lojtarët e regjistruar-anëtarët e FFK-së të Superligës, ligës së I-rë, II-të dhe ligës U-19, U-17 por vetëm me lejen paraprake të klubit dhe organit kompetent
- 2 Lejën nga pika paraprake e jep organi gjegjës kompetent:
- 3 për lojtarë të ligës së parë dhe të dytë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së respektivisht organi që e autorizon Komiteti Ekzekutiv,
- 4 për lojtarë të ligës tretë dhe të tjerët, organi që udhëheq me gara në rangun në të cilin garon klubi i lojtarit i cili ushtron kërkesën.
- 5 Lojtarëve të huaj, klubi për të cilin janë regjistruar, duhet t'ua lejojë paraqitjen për reprezentacionin e tyre nacional, sipas Rregullorës mbi statusin dhe transferin e lojtarëve të FIFA-së.

Neni 51

- 1 Në ekipin e U-19 (mosha 17 - 19 vjeq) të drejtë paraqitjeje, 2019/2020 kane lojtaret qe kane lindur me 01.01.2001 e me te rinje. Me te rinjet se 17 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i lëshuar nga Mjekësia sportive apo institucionet relevante.
- 2 Në ekipin e U-17 (mosha 15 - 17 vjeq) të drejtë paraqitjeje, 2019/2020 kane lojtaret qe kane lindur me 01.01. 2003 e me te rinje. Me te rinjet se 17 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.
- 3 Në ekipin e U-15 (mosha 13 – 15vjeq) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2019/2020 kane lojtaret qe kane lindur me 01.01.2005 e me te rinje. Me te rinjet se 13 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.

- 4 Në ekipin e U-13 (mosha 11 – 13 vjeq) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2019/2020 kane lojtaret qe kane lindur me 01.01.2007 e me te rinje. Me te rinjet se 11 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.
- 5 Në ekipin e U-11 (mosha 9 – 11 vjeq) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2019/2020 kane lojtaret qe kane lindur me 01.01.2009 e me te rinje. Me te rinjet se 9 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.
- 6 Në ekipin e U-9 (mosha 7 - 9 vjeq) të drejtë paraqitjeje, në edicionin e garave 2019/2020 kanë lojtarët që kanë lindur me 01.01.2009 e më të rinj. Më të rinjtë se 7 vjeq mund të aktivizohen me kontrollim special mjekësor i cili është i vërtetuar -vulosur në Lidhjet Rajonale- FFK.
- 7 Nëse klubi luan në ndeshje publike me lojtar i cili nuk i plotëson kushtet e sipërshënuara, atëhere klubi dhe lojtari janë përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores dicitpinore të FFK-së, me atë që klubi do të bartë edhe pasojat tjera të parapara me këtë Rregullore.

Neni 52

- 1 Lojtari nuk mund të luajë në ditën e njëjtë në dy ndeshje zyrtare.
- 2 Lojtaret e nje Klubi, qe garon ne te njejten kategori me dy ekiye (A, B) nuk munden te luajn ne te njejten rang garash, pa kaluar nga njeri ekip te tjetri (A-B) ne afatin kalimtar te lojtareve veror apo dimeror.
- 3 Nje ekip mundet qe gjat nje sezone futbollistike ti licencoj per gara maksimum 35 futbollist.
- 4 Lojtarët e rinj të një klubi mund të inkuadrohen në ekipin e grupmoshavesë veta nga U9 e deri te ekipi A, nëse janë të regjistruar dhe licencuar për kampionatin aktual dhe e kanë moshën e lejuar. Nëse klubi luan në ndeshje publike me lojtar i cili në ditën e njëjtë me herët ka luajtur një ndeshje, klubi dhe lojtari do të jenë subjekt i procedurës disiplinore sipas sipas dispozitave të Rregullores Disiplinore të FFK-së. Klubi, gjithashtu, do të bartë edhe pasojat tjera të parapara me këtë Rregullore, nëse kundërvajtja është kryer në ndeshjen e garave të përhershme.
- 5 Nëse klubi luan në ndeshje publike me lojtarë i cili në ditën e njëjtë ka luajtur një ndeshje më parë, do të hapet procedura disiplinore kundër klubit dhe atij lojtari sipas dispozitave të Rregullorës disiplinore të FFK-së, si dhe, klubi do të bartë edhe pasojat tjera të parapara me këtë Rregullore, nëse kjo kundërvajtje është kryer në ndeshjen e garave të përhershme.
- 6 Në garat e përhershme të FFK-së është lejuar paraqitja e numrit të përcaktuar të lojtarëve me shtetësi të huaj:
- 7 Për Superligë max 6 lojtarë të huaj mund të paraqiten në Raportin zyrtar të ndeshjes dhe në lojë. Për Ligën e parë 4 (katër) ndërsa për Ligat e dyta dhe te kategoria e U-19; U-17; U-15; 2 (dy) lojtarë shtetas të huaj.

Neni 53

Nëse me vendimin e organit kompetent është caktuar që të përsëritet ndeshja e garave të përhershme, në ndeshjen e re mund të luajnë të gjithë lojtarët që kanë të drejtë loje në ditën e zhvillimit të ndeshjes së re.

XVI VËRTETIMI I IDENTITETIT TË LOJTARËVE

Neni 54

- 1 Në ndeshjet kampionale dhe për KUP mund të luajnë të gjithë lojtarët identiteti i të cilëve vërtetohet përmes ID, të lëshuara nga ana e organit kompetent për regjistrimin e lojtarëve, por në mungesë të ID, identiteti i tyre vërtetohet përmes letërnjoftimit apo dokumentit të udhëtimit (pasaportës) dhe përjashtimisht lojtari fotografohet para fillimit të ndeshjes nga delegati.
- 2 Identitetin e lojtarëve dhe lojtarëve rezervë e vërteton delegati në praninë e përfaqësuesve të klubeve para fillimit të ndeshjes, ndërsa pas përfundimit të ndeshjes vetëm për ata lojtarë rezerve të cilët nuk kanë arritur në fillim të ndeshjes.
- 3 Mënyra e vërtetimit të identitetit për lojtarë të kategorisë së të rinjëve, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë ID apo letërnjoftime para ndeshjes, rregullohet me Rregullorën e garave për të rinjë.
- 4 Përjashtimisht nga dispozitat në alinetë e sipërsënuara mund që në rrezik vetanak të angazhohë në ekip lojtarin i cili nuk e ka ID apo letërnjoftimin ose dokumentin e udhëtimit, por me kusht që identiteti i këtij lojtari të vërtetohet më së voni 15 min pas përfundimit të ndeshjes dhe ajo të konstatohet në raportin e ndeshjes.

XVII KONTROLLIMI MJEKËSOR I LOJTARËVE

Neni 55

- 1 Kontrollimi mjekësor është i obliguar të kryhet para fillimit të çdo sezone dmth. 2 herë në vit, çdo 6 muaj. Kontrollimi mjekësor për çdo gjysëm sezon është i obligueshëm edhe për ata lojtarë të cilët regjistrohen në mes të sezonit.
- 2 Kontrollimi special mjekësor për lojtarë të rinj (U19, U17, U15, U13, U11, U9) që do të luajnë në ekipin e parë vlen 6 muaj. Me kontrollim mjekësor special derisa ai është i vlefshëm, lojtari mund të luajë në të gjitha ndeshjet, vetem nëse e ka vërtetimin e lëshuar nga organi i Mjekësisë Sportive të dorëzuar në FFK ose nga specialistë të mjekësisë sportive (ndonjë institucion i licencuar).
- 3 Kontrollimi special mjekësor për lojtarë të rinj (U-19, U-17, U-15) që do të luajnë në ekipin e parë vlen 6 muaj. Me kontrollim mjekësor special derisa ai është i vlefshëm, lojtari mund të luajë në të gjitha ndeshjet, vetem nëse e ka vërtetimin e lëshuar nga organi i Mjekësisë Sportive të dorëzuar në FFK ose nga specialist të mjekësisë sportive (ndonjë institucion i licencuar).
- 4 Lojtari i cili nuk është kontrolluar nga mjeku në afatin e caktuar ose të cilit i është ndaluar e drejta për lojë nga ana e mjekut ose gjendet në pushim mjekësor si dhe lojtarëve të cilëve pa kontrollimit mjekësor mjeku nuk i ka lëshuar vërtetimin mbi kryerjen e kontrollimit mjekësor, nuk mund të luajë (paraqitet) në ndeshjet publike.
- 5 Në raste të posaçme, lojtari për të cilin në mungesë të ID së futbollit nuk mund të vërtetohet se e ka kryer kontrollimin mjekësor ose në mungesë të vërtetimit mbi kontrollimin mjekësor, klubi mund të angazhohë atë në ekip në përgjegjësi vetanake, me atë që në afatin prej 24 orëve nga përfundimi i ndeshjes t'ia dorëzoj organit garues ID ose vërtetimin mbi kontrollin mjekësor ku pa kurrfarë

dyshimi mund të vërtetohet se lojtari ka pasur të kryer kontrollimin mjekësor të vlefshëm për ndeshjen e cekur kampionale ose KUP.

- 6 Procedurë disiplinore do të ngritet ndaj, lojtarit, klubit dhe zyrtarit i cili lejon paraqitjen e lojtarit në ndeshje që nuk kanë kontrollim mjekësor të kryer valid, konform rregullorës së garave.
- 7 Kontrollimi mjekësor i lojtarëve duhet të kryhet në institucionin shëndetësor sportiv (nëse ka) apo në institucione publike shëndetsore ose private nëse Komisioni Mjekësor i FFK-së i pranon si të afta për kryerjen e kontrollimit mjekësor.
- 8 Klubet duhet të dorëzojnë pranë Komisionit mjekësor apo Komisionit për licencim të FFK-së regjistrin e lojtarëve të cilët kanë kryer kontrollimin mjekësor, të atyre të cilët kanë rezultuar të aftë për gara dhe të atyre të cilët nuk kanë marrë lejen për garim nga Komisioni mjekësor, para fillimit të sezonit garues veror apo dimëror.
- 9 Lojtarët të cilët gjatë kontrollimit mjekësor një herë kanë dalë si të pa aftë për gara duhet të bëjnë kërkesë Komisionit Mjekësor apo Komisionit për licencim të FFK-së për përsëritje të procedurës së kontrollimit mjekësor dhe një gjë të tillë mund ta bëjnë vetëm pasi që komisioni të këtë lejuar rikontrollimin mjekësor. Në gara mund të mere pjesë pasi t'a këtë kaluar me sukses kontrollimin mjekësor.
- 10 Përsëritja e procedurës për rikontrollim mjekësor nuk mund të bëhet pa kaluar së paku 15 ditë nga dita e kontrollimit mjekësor.
- 11 Në të gjitha ndeshjet kampionale, për kup dhe lojë miqësore të të gjitha kategorive klubet janë të obliguara të kenë fizioterapeutin dhe mjekun e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- 12 Asnjë ndeshje e asnjë kategorie të futbollit në kuadër të FFK-së nuk mund të zhvillohet nëse njëri klub nuk e ka së paku fizioterapeutin ose mjekun prezent dhe të gatshëm për dhënje të ndihmës mjekësore.
- 13 Nëse klubi nuk posedon as mjekun as fizioterapeutin për dhënje të ndihmës mjekësore ndeshja nuk mund të zhvillohet ndërsa ekipi i tillë e humb ndeshjen me rezultat zyrtar. Në raste të jashtëzakonshme kur për shkaqe të ndryshme as mjeku as fizioterapeuti nuk kanë arritur me kohë në stadium ata mund të priten më se shumti 15 minuta nga koha kur është dashur të zhvillohet ndeshja.
- 14 Delegati i ndeshjes duhet të shënojë saktë në raport arsyen për vonesë ose për mos zhvillim të ndeshjes.
- 15 Kundër klubeve dhe lojtarëve të cilët shkelin dispozitat paraprake, do të inicohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores disiplinore të FFK-së.
- 16 Si vërtetim zyrtar në kuptim të alinesë 1 dhe 3 të këtij neni konsiderohet vërtetimi i dhënë në bazë të regjistrit zyrtar mbi kontrollimin e kryer mjekësor.
- 17 Përjashtim bëjnë kategoritë e reja (U17 dhe më të rinj) ku ekipi nikoqir është i obliguar që të këtë mjekun apo fizioterapeutin e licencuar. Sugjerohet fuqishëm që edhe ekipi mysafir t'a këtë mjekun. Nëse ekipi vendas nuk e ka as mjekun e as fizioterapeutin e licencuar, atëherë humb ndeshjen me rezultat zyrtar.

Neni 56

- 1 Klubi nikoqir është i obliguar që të siguron shërbimin mjekësor në të gjitha ndeshjet publike të njoftoj me shkrim qendrën shëndetësore me të afërt për zhvillimin e ndeshjes.
- 2 Shërbimi mjekësor duhet të jetë i siguruar së paku 60 minuta para fillimit të ndeshjes, respektivisht gjatë ndeshjës dhe 30 minutat pas përfundimit të ndeshjes
- 3 Klubet janë të obliguara që para fillimit të çdo sezone në FFK të sjellin kontratat me institucione shëndetësore, personelin profesional të mjekësisë lidhur me angazhimin e tyre për cdo ndeshje zyrtare.

Neni 57

Nëse ekipa mjekësore – ambulanta nuk është e pranishme në perimetrin e stadiumit apo në afërsi të stadiumit, por organizatori garanton se do të jetë në stadium mbrenda 15 min pra do të jetë gati për intervenim eventual, referi do të lejoj fillimin e ndeshjes (gjithësesi nëse ekipet mjekësore të dy ekipeve janë present) ndërsa delegati do ta konstatojë në raportin e tij dhe do të hapet procedurë disiplinore kundër organizatorit.

XVIII MOSZHVILLIMI DHE NDËRPRERJA E NDESHJES

Neni 58

- 1 Nëse klubi nikoqir nuk e ka aftësuar terrenin për lojë për shkaqe të paarsyeshme para fillimit ose gjatë zhvillimit të ndeshjes, ndërsa Referi vendos që ndeshja nuk mund të fillojë ose ndeshja e ndërprerë të mos vazhdojë duhet të konstatohet në raport, se është përgjegjës sipas dispozitave të Rregullores disiplinore të FFK-së, ndërsa ndeshja regjistrohet me rezultat 3:0 (par-forfe) në të mirë të ekipit kundërshtar (nëse vërtetohet se ekipi nikoqir nuk ka ndërmarrë masat e duhura për zhvillimin e ndeshjes zyrtarete cilat janë shkaqe teknike jo fuqi madhore).
- 2 Nëse ndeshja e garave të përhershme, është ndërprerë për shkaqe të arësyeshme të cilat nuk kanë mundur të evitohen (koha e keqe, mjegulla, terri, zjarri, tërmeti etj), për çka vendos Referi, ndeshja do të zhvillohet ditën e nesërme gjithësesi para ndeshjeve së gjiros të rregullt të radhës (nëse ka kushte) nga ajo minutë në të cilën ka ardhur deri te ndërprerja e ndeshjes.
- 3 Ekipi i cili nuk paraqitet për zhvillimin e ndeshjes së re, të cilën e cakton organi kompetent, përgjigjet sipas dispozitave të Rregullores disiplinore të FFK-së, ndërsa ndeshja do të regjistrohet me rezultat 3:0 (par-forfe) në favor të kundërshtarit.
- 4 Vendimin mbi regjistrimin e ndeshjes me rezultat 3:0 (par-forfe) nga pika 1 dhe 4 e këtij neni e merr organi i cili udhëheq me gara, sipas detyrës zyrtare.
- 5 Nëse të dy ekipet pa arsye nuk paraqiten për zhvillimin e ndeshjes së re, konsiderohet se nuk janë të interesuara t'i vazhdojnë garat e mëtutjeshme, andaj bartin pasojat e parapara me akte të përgjithshme normative të FFK-së.

Neni 59

- 1 Ekipi i cili e lëshon terrenin, respektivisht ekipi i cili shkakton ndërprerjen e ndeshjes, duke përfshirë edhe ndërprerjen e ndeshjes që e ka shkakuar lojtari i asaj ekipe, humbë ndeshjen me rezultat 3:0 (par-forfe), nëse deri te ndërprerja kundërshtari nuk ka arritur rezultat më të mirë.
- 2 Vendimi mbi regjistrimin e ndeshjes me rezultat 3:0 (parforfe) e merr organi i cili udhëheqë me gara, sipas detyrës zyrtare.
- 3 Ekipi i cili është shkakuar i ndërprerjes së ndeshjes, i nënshtrohet edhe masave ndëshkuese disiplinore të parapara me Rregulloren disiplinore.

Neni 60

- 1 Nëse ndeshja është ndërprerë për shkak të incidentit, trazirave, numrit jo të mjaftueshëm të lojtarëve, mos respektimit të vendimit të Referit për përjashtimin e lojtarit dhe largimin e tij prej terreni, etj. e poqëse vërtetohet se për ndërprerje të ndeshjes fajtor është njëri prej ekipeve pjesëmarrëse, ekskluzivisht apo në pjesën dërmuese, ndeshja do të regjistrohet me rezultat 3:0 (par-forfe) në favor të ekipit kundërshtar, me kusht që deri në ndërprerjen e ndeshjes nuk ka arritur rezultat më të mirë.
- 2 Nëse organi që udhëheqë me gara e vërteton se për ndërprerje të ndeshjes, nuk është fajtor asnjëri prej ekipeve pjesëmarrëse, respektivisht për ndërprerjen janë fajtor në mënyrë të barabartë të dy klubet dhe se organizatori i ndeshjes ka ndërmarrë të gjitha masat e parapara me dispozitat e FFK-së, rreth organizimit dhe sigurimit dhe rendi në ndeshje të rangut të caktuar të garave atëherë organi kompetent mund të vendos që të zhvillohet ndeshja e re ose ndeshja e ndërprerë të regjistrohet me rezultatin e arritur.
- 3 Në rast të ndërprerjes së ndeshjes për shkak të trazirave apo incidentit serioz, organi i cili udhëheqë me gara mund ta suspendojë ekipin fajtor që mos t'i zhvillojë ndeshjet e garave të përhershme në stadiumin e caktuar apo në stadiumet e territorit të caktuar.

NDALESA PËR TË LUAJTUR PËR SHKAK TË SUSPENDIMIT DHE PASOJAT

Neni 61

- 1 Ekipi i suspenduar respektivisht të gjithë lojtarët e klubit të suspenduar, nuk mund të luajnë në ndeshje publike derisa zgjatë suspendimi.
- 2 Të gjitha ndeshjet të cilat janë të parapara gjatë kohës së suspendimit të shqiptuar, e të cilat ekipi i suspenduar nuk i zhvillon për shkak se nuk i ka përmbushur obligimet që rrjedhin nga vendimet e plotëfuqishme të organeve kompetente të FFK-së, ose për shkak të mos përmbushjes së obligimeve tjera që rrjedhin nga vetë zhvillimi i garave, do të regjistrohen me rezultat 3: 0 (par-forfe) në favor të kundërshtarit. Ndeshjet të cilat ekipi i suspenduar nuk ka mundur t'i zhvillojë gjatë kohës së suspendimit të shqiptuar, për shkak se duhet bërë vërtetimin e gjendjes faktike, e cila është e domosdoshme për marrjen e vendimit definitiv lidhur me ndonjë rast kontestues, nuk do të regjistrohen derisa mos të mirret vendimi definitiv. Pas marrjes së vendimit definitiv, klubi është i obliguar t'i zhvillojë ndeshjet sipas orarit që e përcakton organi kompetent për udhëheqjen me gara.

- 3 Nëse ekipi i suspenduar luan në ndeshje publike, atëherë ndaj tij do të inicitohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullores disiplinore, po ashtu klubi do të bartë edhe pasojat garuese nëse lidhur me ndeshjen e zhvilluar është ushtruar ankesa sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

XIX TËRHEQJA NGA GARAT DHE FUZIONIMI I KLUBEVE

Neni 62

- 1 Nëse Klubi i futbollit, gjatë zhvillimit të Kampionatit me vetëdëshirë tërhiqet nga garat e metutjeshme, apo Komisioni i garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve (për Senior) dhe tri ndeshjeve (për kategoritë e reja), apo për arsye tjera të parapara me Rregullore disiplinore, atëherë ai Klub do të fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të duhej t'i zhvillonte veprohet me sa vijon:
- 2 Nëqoftëse një ekip me vetëdëshirë largohet nga garat e mëtutjeshme apo Komisioni i garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve, atëherë ai ekip do të fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të zhvillonte do të veprohet kështu:
- 3 Nëse klubi tërhiqet ose përjashtohet nga garat pasi që të ketë zhvilluar gjysmën e ndeshjeve apo më pak nga numri i përgjithshëm i ndeshjeve të parapara për tërë kampionatin, atëherë të gjitha ndeshjet e tij të zhvilluara anulohen.
- 4 Nëse klubi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi të ketë zhvilluar më tepër se gjysmën e numrit të përgjithshëm të ndeshjeve të parapara për atë kampionat, atëherë ndeshjet e tij të zhvilluara deri në atë moment do të regjistrohen me rezultate të arritura, ndërsa ndeshjet e mbetura deri në fund të kampionatit nuk do të zhvillohen dhe do të regjistrohen me rezultat zyrtar(3:0) në favor të kundërshtarëve të tij të ardhshëm të paraparë me kalendar të garave.
- 5 Ndeshje e zhvilluar në kuptim të këtij neni konsiderohet ndeshja e zhvilluar në fushë dhe e regjistruar me rezultat të arritur në fushë apo rezultat zyrtar (në rast të ankesës së aprovuar).
- 6 Nëse garat zhvillohen sipas sistemit të njëfishtë të pikëve, konsiderohet se klubi e ka zhvilluar gjysmën e ndeshjeve, nëse është paraqitur në mbi 50% të ndeshjeve nga numri i tërësishëm i ndeshjeve të parapara me orarin e rregullt të garave. Nëse klubi i caktuar e fiton të drejtën për të hyrë në rang më të lartë të garave dhe nuk i plotëson kushtet e parapara me dispozita për atë rang të garave apo i njëjti klub tërhiqet me vetë dëshirë, atëherë vendin në rangun më të lartë të garave ia lëshon klubit tjetër. Të drejtën për gara në rang më të lartë, të cilën nuk e shfrytëzon klubi që e zënë vendin e dytë e ka klubi që ka zënë një vend më poshtë se sa klubi që nuk e shfrytëzon këtë të drejtë.
- 7 Nëse para fillimit të kampionati një klub nuk licencohet apo tërhiqet nga garat KE do të vendos për plotësimin e vendit të lirë apo mos plotësim dhe për nivelin e garimit të klubit që është tërhiqur nga garat apo që nuk është licencuar

- 8 Nëse gjatë zhvillimit të garave, për shkaqe të ndryshme tërhiqen apo largohen nga garat një apo më shumë ekipe të rangut të caktuar, atëherë ai rang i garave nuk do të plotësohet me ekipe të rangut më të ulët.

FUZIONIMI I KLUBEVE

Neni 63

- 9 Fuzionimi i klubeve bëhet në Kuvendin e përbashkët të klubeve të interesuara të cilat më parë në kuvendet e tyre veç e veç janë deklaruar për fuzionim.
- 10 Fuzionimi kryhet para fillimit të kampionatit të ri, dhe atë më së voni 30 ditë para fillimit të pjesës vjeshtore. Klubet e fuzionuara duhet të gjejnë një emër ndryshe nga ai që kanë pasur para fuzionimit.
- 11 Klubi i cili është rezultat i fuzionimit, pas fuzionimit mbanë të drejtat e ekipit më të mirë të plasuar (të klubeve të fuzionuara), si të ekipit të seniorëve, juniorëve, kadetëve, pionerëve, veç e veç për secilën garë në të cilën kanë garuar ekipet gjegjëse të klubeve të fuzionuara.
- 12 E drejta e paraqitjes dhe mënyra e regjistrimit të anëtarëve (deri në momentin e fuzionimit) të klubeve të fuzionuara, përcaktohen me Rregulloren mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve.

Neni 64

- 1 Klubi i cili tërhiqet nga garat kampionale bjen në rang më të ulët të garave, pa marrë parasyshë rezultatet e arritura në gara deri në momentin e tërheqjes.
- 2 Konsiderohet se klubi (senior) është tërhequr nga garat nëse me fajin e vet nuk i ka zhvilluar dy ndeshje pa arsye të asaj gare gjatë një viti garues, ndërsa në kategoritë e reja kjo vlen pas tri ndeshjeve. Ekipet të cilat tërhiqen nga garat e të cilat i takojnë kategorisë më të ulët të garave të FFK-së, nuk mund të regjistrohen sërish në të njëtin rang të garave së paku 1 vjet.
- 3 Ndaj klubit i cili tërhiqet nga garat, inicohet procedura disiplinore sipas dispozitave të Rregullorës disiplinore të FFK-së.
- 4 Në qoftëse një ekip me vetëdëshirë largohet nga garat e mëtutjeshme apo Komisioni i garave e largon për shkak të moszhvillimit të dy ndeshjeve, atëherë ai ekip do të fshihet nga garat e mëtutjeshme, kurse për ndeshjet e zhvilluara dhe ato që do të zhvilloheshin do të veprohet kështu:
- 5 Nëse klubi tërhiqet ose përjashtohet nga garat pasi që të ketë zhvilluar gjysmën e ndeshjeve apo më pak, nga numri i përgjithshëm i ndeshjeve të parapara për tërë kampionatin, atëherë të gjitha ndeshjet e tij të zhvilluara anulohen.
- 6 Nëse klubi tërhiqet apo përjashtohet nga garat pasi të ketë zhvilluar më tepër se gjysmën e numrit të përgjithshëm të ndeshjeve të parapara për atë kampionat, atëherë ndeshjet e tij të zhvilluara deri në atë moment do të regjistrohen me rezultate të arritura, ndërsa ndeshjet e mbetura deri në fund të kampionatit nuk do të zhvillohen dhe do të regjistrohen me rezultat zyrtar (3:0) në favor të kundërshtarëve të tij të ardhshëm të paraparë me kalendar të garave.
- 7 Ndeshje e zhvilluar në kuptim të këtij neni konsiderohet ndeshja e zhvilluar në fushë dhe e regjistruar me rezultat të arritur në fushë apo rezultat zyrtar (në rast të ankesës së aprovuar).

FSHIRJA E KLUBIT NGA GARAT

Neni 65

- 1 Klubi obligohet që detyrimet e veta, të cilat burojnë nga Rregullorja e garave dhe aktet tjera normative të FFK-së, t'i përmbushë në afatet të cilat përcaktohen me aktet normative.
- 2 Përjashtimisht në rastet posaçërisht të arsyeshme, organi i cili udhëheq me gara, mund t'i shtyjë (prolongojë) afatet për përmbushjen e detyrimeve, mirëpo gjithësesi duke pasur kujdes që detyrimet e klubeve nga një sezon garues duhet të përmbushën me së voni 30 ditë para fillimit të garave në sezonin tjetër.
- 3 D.m.th. detyrimet nga sezoni vjeshtor duhet të përmbushen më se voni 30 ditë para fillimit të sezonit pranveror, ndërsa detyrimet e stinorit pranveror më se voni 30 ditë para fillimit të vitit të ri garues.
- 4 Klubi i cili nuk vepron në pajtim me dispozitat e alinesë së lartëshënuar, me vendimin e organit kompetent garues do të fshihet nga garat e mëtejme, ndërsa nëse është fjala për detyrimet nga pjesa pranverore e kampionatit, nuk do t'i lejohet pjesëmarrja në garat e reja.

Neni 66

- 1 Ekipi i cili e fiton ndeshjen në garat kampionale inkason 3 pikë, kurse nga ndeshja rezultati i të cilës është i barabartë, secili klub inkason nga një pikë.
- 2 Për secilën garë të përhershme e cila zhvillohet sipas sistemit të pikëve, përpilohet (mbahet) tabela.
- 3 Tabela përmban: emrat e ekipeve, numrin e ndeshjeve të zhvilluara, rezultatet e arritura në këto ndeshje, numrin e pikëve të fituara dhe numrin e golave të shënuara respektivisht të pranura (pësuar).
- 4 Plasmani i ekipeve në tabelë caktohet në bazë të pikëve të fituara. Plasman më të mirë siguron ekipi i cili ka fituar më shumë pikë.
- 5 Plasmani i ekipeve në tabele në 22 xhirot, caktohet në baze të pikeve të fituara, nëse ekipet kanë plasman të barabartë atëherë shikohet golaverazhi;
- 6 Nëse ekipet që kanë plasman të barabartë në tabele (në fund të sezonit), e garojnë për kreun e tabelës (titullin e kampionit), daljen në gara ndërkombëtare, largimin në rang më të ulët, (mbetje, hyrje në ligë): do të merret për bazë rezultati dhe golaverazhi në takimet e ndërsjellta;
- 7 Nëse ekipet kanë plasman të barabartë edhe në takimet e ndërsjellta atëherë mirren për bazë golat e shënuara në kampionat gjegjësisht cili ekip ka shënuar më shumë gola;
- 8 Nëse ekipet i kanë edhe golat e shënuar gjatë kampionatit të barabartë, atëherë merren për bazë golat e shënuar si mysafir gjatë kampionatit.
- 9 Nëse edhe në këtë në mënyrë nuk mund të vërtetohet plasmani atëherë zhvillohen ndeshje në mes të ekipeve dhe atë:
- 10 Një ndeshje në fushën neutrale (nëse janë dy ekipe) që e cakton KE, e nëse pas 90 min, rezultati është i barabartë pasojnë shtyerja 2x15 min. e në rast rezultati të barabartë pasojnë penaltitë.
- 11 Tri ndeshje me sistem të pikëve të njëfishta në terren neutral, nëse janë në kombinim 3 ekipe,
- 12 Numër i nevojshëm i ndeshjeve në sistem të njëfishtë të pikëve, në terren neutral, nëse janë në kombinim 4 ose më tepër ekipe.

- 13 Nëse ekipet e theksuara në pikën paraprake arrijnë marrëveshje ndërmjet veti, në vend të zhvillimit të këtyre ndeshjeve, çështjen e fituesit mund ta përcaktojnë edhe me short, të cilin do ta udhëheq organi kompetent i garave.

XX PËRFAQËSIMI I KLUBEVE NË GARA NDËRKOMBËTARE

Neni 67

Përfaqësimi i ekipeve në Garat Ndërkombëtare:

- 1 Ekipi i cili shpallet kampion në garat kampionale përfaqëson Kosovën në garat e UEFA-së (Liga e Kampionëve).
- 2 Ekipi nënkampion apo edhe më poshtë i klasifikuar mund të merr pjesë në garat e UEFA-s nëse mundësohet kjo nga UEFA në bazë të koeficientit zyrtar për pjesëmarrje.
- 3 Ekipi i cili shpallet fitues i Kupës së Kosovës, përfaqëson Kosovën në garat UEFA Euroligë;
- 4 Nëse ekipi fitues i KUP-ës së Kosovës, për shkaqe të ndryshme nuk e përfaqëson Kosovën (nuk licencohet për garat e UEFA Euroligës), atëherë zëvendësohet me ekipin e radhës (që nuk është pjesëmarrës i garave të UEFA-s) që ka plasmanin më të mirë respektiv në kampionatin e rregullt të Kosovës, e jo finalisti i KUP-ës, me kusht që të jetë i licencuar paraprakisht për garat e UEFA-s.

SISTEMI I KUPËS

Neni 68

- 1 Garat e KUP-ës së Kosovës, zhvillohen në sistemin e tillë që së pari, në xhiron e parë, me gara fillojnë ekipet nga Lidhjet rajonale e të Ligës së II-të dhe të Ligës së Parë (një xhiro), nga të cilat me sistem të eliminimit (vetëm një ndeshje), për gara të mëtutjeshme do të kualifikohen ekipet që kanë fituar ndeshjet.
- 2 Garat për KUP i udhëheq Komisioni unik për Superligë dhe Ligë të Parë. Në xhiron e tretë, fituesve bashkangjiten edhe 12 ekipet e SuperLigës.
- 3 Në Gjysëmfinalët e Kupës, ekipet që mbesin në garë do të zhvillojnë nga dy ndeshje dhe atë një të njërit si nikoqir dhe tjetërën si mysafir (sipas shortit). Organi i cili udhëheq me gara, para çdo xhiroje duhet ta tërheqë shortin i cili duhet të jetë publik. Sipas rregullit, ekipi nikoqir është ekipi i cili i pari tërhiqet me short.
- 4 Me këtë rast, ekipi i cili do të tërhiqet me short i pari do të jetë nikoqir në ndeshjen e parë, respektivisht mysafir në të dytën.

Neni 69

Nëse ndeshja e zhvilluar me KUP-sistem të njëfishtë pas kalimit të kohës së rregullt përfundon me rezultat të barabartë do të zhvillohen vazhdimet. Nëse edhe pas kësaj rezultati është i barabartë atëherë zhvillohen vazhdimet 2 x 15 minuta. Nëse edhe këtu ka rezultat të barabartë, atëherë fituesi do të përcaktohet pas ekzekutimit të penalltive.

Ekzekutimi i penalltive bëhet në mënyrë të paraparë me Bordin Ndërkombëtar - sipas udhëzimeve për ekzekutimin e penalltive për përcaktimin e fituesit në garat eliminuese.

Neni 70

- 1 Në ndeshjet të cilat zhvillohen sipas sistemit të dyfishtë, fitues bëhet ekipi i cili në dy ndeshje ka më shumë pikë.
- 2 Nëse të dy ekipet pas përfundimit të dy ndeshjeve kanë rezultat të njëjtë dhe kanë shënuar numër të njëjtë të golave, për gara të mëtutjeshëm plasohet ekipi i cili ka shënuar më shumë gola si mysafir.
- 3 Nëse edhe në pikëpamje të golave të shënuara si mysafir ekipet janë të barabarta, atëherë për plasman në xhiron e ardhshme do të vendoset me vazhdime e nëse edhe këtu janë të barabartë (pa gola), ekzekutohen penalltitë. Në lojën shtesë 2 x15 min. vlen përparësia e golit të shënuar si mysafir.

Neni 71

- 1 Edhe në ndeshjen FINALE të KUP-ës së futbollit të Kosovës apo atë të Super Kupës, nëse rezultati mbetet i barabartë, do të luhen vazhdimet (dy herë nga 15 minuta). Nëse edhe pas vazhdimeve rezultati është i barabartë, fituesi i KUP-ës do të përcaktohet me ekzekutimin e penalltive.
- 2 Ekzekutimi i penalltive do të bëhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren e IFAB të UEFA-s.

Neni 72

KE i FFK-së mund të quajë KUP-ën e FFK-së, në bazë të Sponzorit eventual dhe për këtë merr vendim të posaçëm. Ndeshja finale e Kupës së Kosovës, do të zhvillohet në stadiumin e qytetit të kryeqytetit të Kosovës, në Prishtinë, nëse KE nuk vendos ndryshe. Lidhur me ndarjen e të hollave të realizuara nga shitja e biletave dhe të hyrave tjera (reklama TV etj.), Komiteti Ekzekutiv i FFK-së mund të vendos me një vendim të posaçëm. Pas përfundimit të finales, gjatë ceremonialit të dorëzimit të Kupës skuadres fituese, skuadra që pëson humbje e ka obligim të qëndron në terren në përbërje complete, në të kundërtën do të ndëshkohet me dënim në para.

Neni 73

FFK-ja, i heqë shpenzimet e blerjes së Kupës për fituesin e kampionatit të Kosovës (kampionin), për fituesin e Kupës së Kosovës dhe për fituesin e ndeshjes së Superkupës, nëse me ndonjë vendim tjetër KE nuk ka vendosur ndryshe.

Neni 74

Në qoftë se ndonjë ekip dënohet me mos lojë në fushën e vetë (vlen edhe për KUP edhe për Kampionat), atëherë ky ekip duhet të sigurojë fushën për ndeshje, e cila duhet të jetë së paku 30 km. larg (rrugë rajonale të asfaltuar) nga stadiumi i saj.

REGJISTRIMI I NDESHJES

Neni 75

- 1 Nëse pas ndeshjes nuk ushtrohet ankesa, e as nuk ekziston baza për regjistrimin e ndeshjes me rezultat zyrtar 3:0 (par-forfe), ndeshja do të regjistrohet me rezultatin e arritur në terren.
- 2 Organi i cili udhëheq me gara i regjistron ndeshjet në afatin e paraparë me Rregulloren e garave gjegjëse, por nuk mund t'i regjistrojë ndeshjet para se të kalojë afati për ushtrimin e ankesës.

XXI MASAT DISIPLINORE KUNDËR ANËTARËVE DHE KLUBEVE

Neni 76

Kundër anëtarëve, klubeve apo personave tjerë juridik mund të aplikohen masat disiplinore si vijon.

- 1 Në lidhje me anëtarët:
 - a) Vërejtje
 - b) gjobë (dënimi në të holla) ;
 - c) anulimi rezultatit të ndeshjes ;
 - d) urdhëri për zhvillimin e sërishëm të ndeshjes ;
 - e) zbritja e pikëve ;
 - f) regjistrimi i ndeshjes në favor të një klubi ;
 - g) zhvillimi i ndeshjes pa spektator;
 - h) zhvillimi i ndeshjes në territor neutral;
 - i) dënimi i stadiumit;
 - j) ndalimi i prodhimit të sinjalit televiziv për një ose më shume ndeshje dhe /ose që sinjali televiziv për një ose më shumë ndeshje të jetë pa pagesë.
 - k) diskualifikim nga ndeshjet në vijim dhe/ose përjashtim nga kampionati i ardhshëm. m) largim ;
 - l) dërgimi në rang më të ulët ;
 - m) ndalimi i transferit;
- 2 Në lidhje me personat privat (individë)
 - a) Vërejtje
 - b) gjobë;
 - c) largim;
 - d) suspendim për një numër të caktuar ndeshjesh ose periudhë të caktuar;
 - e) ndalim prezence në zsheshtore apo bankën e "rezervistëve";
 - f) ndalesa e marrjes pjesë në çdo aktivitet të lidhur me futbollin;
- 3 Shqiptimi i masave të tjera juridike Krahas dënimit për kundërvajtje sipas rregullores disiplinore te FFK-se, personave fizikë dhe juridikë që kanë kryer vepra penale në ngjarjet sportive u shqiptohen edhe masa të tjera të parapara me Kodin Penal të Kosovës.

Neni 77

- 1 Me procedurë disiplinore vendos Komisioni disiplinor i FFK-së unik për të gjitha rangjet, si organ i shkallës së Parë, i rangut përkatës për: lojtarë, klube, trajnerë, gjyqtarë dhe persona zyrtar.
- 2 Komisioni Disiplinor i Lidhjeve Rajonale do të trajtoj kundërvajtjet e kryera në garat e Lidhjes Rajonale dhe është Komisioni i shkallës së parë. Komisioni për Ankesa i FFK-së, vendos mbi të gjitha ankesat disiplinore dhe garuese. Komisioni për Ankesa është unik për të gjitha rangjet e garave dhe garave në Lidhjet rajonale.

Neni 78

Mbrojtjen e Rregullores Disiplinore dhe Akteve tjera normative të FFK-së, e bënë Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, sipas kërkesës së parashtruar. Vendimi i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, është definitiv.

Neni 79

- 1 Lojtari i ndëshkuar me 4 (katër) kartonë të verdhë pushon automatikisht në gjiron e radhës. Dënimi për shkak të 4 vërejtjeve publike (kartonat e verdhë) të shqiptuara në ndeshje kampionale nuk mund të ekzekutohet në ndeshjen për Kup dhe anasjelltas.
- 2 Ky rregull vlen për të gjitha kategoritë. Vuajtja e dënimit bartet edhe në kampionatin vijues të garave nëse bëhet fjalë për kartonin e kuq apo të kuqin pas dy të verdhëve, si dhe bartet edhe dënimi i marrë në ndeshjen e fundit (kartoni i 4 i verdhë me radhe) në ndeshjen e parë kampionale vijuese. Kartonat e tjerë të verdhë shlyhen dhe nuk barten në kampionatin vijues. Dënimi automatik për shkak të dy vërejtjeve publike (kartonave të verdhë) në ndeshjet për Kupën e Kosovës, do të ekzekutohet në ndeshjen e parë të radhës për Kupën e Kosovës. Lojtari i cili gjatë një ndeshjeje ndëshkohet me kartonin e dytë të verdhë, automatikisht ndëshkohet me të kuqin, dhe pushon xhiron e radhës (edhe gjiron e parë të kampionatit të ardhshëm). Ky dënim nuk mund të ekzekutohet në garat për KUP. Lojtari i cili ndëshkohet direkt me karton të kuq detyrimisht pushon xhiron e radhës qoftë për gara të rregullta, qoftë për garat e KUP-ës.
- 3 Lojtari i cili ka marrë kartonin e kuq në ndeshjet e U-19 nuk mund të paraqitet në ndeshjet e ekipit senior pa e vuajtur dënimin në ekipin e U-19.

Neni 80

Secili klub është i obliguar që të udhëheq evidencën e vërejtjeve publike të lojtarëve të vet. Shërbimi administrativ i FFK-së, në bashkëpunim me Komisionin e Garave, udhëheq evidencën mbi vërejtjet publike, bën regjistrimet dhe ato i shpallnëfaqen zyrtare të FFK-së. Mosshpallja në faqen zyrtare të FFK-së nuk e liron klubin nga obligimi për të ekzekutuar dënimin e shqiptuar nga komisioni përkatës. Është përgjegjësi ekskluzive e klubit që të evidentojë kartonat dhe dënimet tjera të lojtarëve apo zyrtarëve dhe të drejtën e lojës apo paraqitjes zyrtare.

Neni 81

Nëse vërtetohet se Klubi mikëpritës i cili e zhvillon ndeshjen në fushë të vetë apo në fushën e kontraktuar, nuk ka ndërmarrë masa të mjaftueshme për t'i penguar incidentet, para, gjatë dhe pas ndeshjes do të dënohet në bazë të Rregullorës disiplinore të FFK-së. E njejta do të ndodhë edhe me Klubin mysafir, simpatizuesit e të cilëve kanë inicuar apo kanë marrë pjesë në incident.

Neni 82

Nëse ndeshja ndërprehet për shkak të sulmit fizik ndaj gjyqtarëve apo lojtarëve, e njëjta do të regjistrohet me rezultat zyrtar 3:0, kurse ndaj ekipit dhe shkaktarit të incidentit, do të inicohet procedura disiplinore. Nëse shkaktari i ndërprerjes nuk është asnjëri ekip apo shikuesit, por të njëjtën e ndërprehen referi pa ndonjë arsye të madhe, (e kjo dëshmohet pas verifikimit të gjithanshëm), e njëjta do të përsëritet. Kundër gjyqtarit për të cilin konstatohet se ka referuar njëanshëm (ka marrë vendime të njëanshme), inicohet procedura disiplinore.

Neni 83

- 1 Në qoftë se ekipi nuk paraqitet në ndeshje për shkaqe të pa arësyeshme, ndeshjen e humb me rezultat zyrtar 3:0 dhe mund të dënohet me marrjen (minus pikëve) prej 3 e deri 9 pikëve nga pikat e përgjithshme të fituara, apo të 9 pikëve negative.
- 2 Nëqoftëse një ekip pa arsye nuk paraqitet në (2) dy ndeshje (ndërsa mungesën nuk e ka arsyetuar) gjatë një kampionati (vjeshtor – pranveror), do të largohet nga garat e mëtejme.
- 3 Tek U-19 përjashtimi bëhet pas mungesës në 3 (tri) ndeshje pa arsye. Ekipi i cili xhirot e fundit nuk udhëton në ndeshje pa arsye mund të dënohet nga Komisioni i Garave përkatëse me minus tri deri minus gjashtë pikë për sezonin e ardhshëm garues.

Neni 84

- 1 Ekipi i cili gabon teknikisht fut lojtarin në raport zyrtarë ose lojë, pa të drejtën e lojës humbë ndeshjen me rezultat zyrtarë 3:0 (ndaj klubit dhe lojtarit inicohet procedurë disiplinore).
- 2 Ekipi i cili e përsërit gabimin në një kampionat garues me futjen e lojtarit në raport zyrtarë ose lojë, pa të drejtën e lojës, e humb ndeshjen me rezultatin 3:0 (ndaj klubit dhe lojtarit inicohet procedurë disiplinore) dhe i mirren -3 pike.
- 3 Ekipi i cili gabon teknikisht në një kampionat garues me futjen e lojtarit në raport zyrtarë ose lojë, pa pasë të drejtën e lojës në 3 xhirot e fundit të kampionatit e humb ndeshjen me rezultatin 3:0 (ndaj klubit dhe lojtarit inicohet procedurë disiplinore) dhe i mirren -9 pike.

XXII ANKESA NDAJ NDESHJES SË ZHVILLUAR

Neni 85

- 1 Mbi rregullsinë e ndeshjes së garave të përhershme mund të vendoset në bazë të ankesës së klubit të dëmtuar ose sipas detyrës zyrtare të organit i cili udhëheq me gara (organ i shkallës së parë)
- 2 Me klub të dëmtuar në kuptim të pikës së parë të këtij neni, nënkuptohet klubi i cili është i dëmtuar me rezultat të ndeshjes, ndaj të cilës ushtrohet ankesa.
- 3 Ankesa mbi të gjitha bazat duhet të paralajmërohet në Raportin e ndeshjes, në mënyrë telegrafike ose më së largu në afat prej 24 orëve, nga përfundimi i ndeshjes ndërsa taksën e paguar, duhet të dorëzohet me afat më së largu prej 48 orëve nga përfundimi i ndeshjes.
- 4 Nëse afati për ushtrimin e ankesës skadon në ditën e dielë ose në ditën e festes shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës.
- 5 Ushtrimi jo me kohë si dhe ankesa e pataksuar apo e taksuar jo në tërësi do të hudhet poshtë.

- 6 Komisioni i garave si organ i shkallës së parë, është i obliguar që në afat prej 3 ditësh, e në raste kur kërkohet zgjidhje urgjente edhe më shkurt (nga dita e marrjes së ankesës), ta shqyrtojë ankesën.
- 7 Komisioni Disiplinor është organ i shkallës së parë, merret me shqiptimin e dënimeve kryesve të mundshëm (Klubeve, lojtarëve, zyrtarëve, etj.) në bazë të Rregullorës Disiplinore të FFK-së.
- 8 Pala e paknaqur në vendimin e Komisionit të garave ka të drejtën e ushtrimit të ankesës në Komisionin e Apelit, 3 ditë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të FFK-së.
- 9 Komisioni i Apelit merr vendim më së largu 5 ditë, nga dita e ushtrimit të ankesës.
- 10 Pala e pakënaqur në vendimin e komisionit të Apelit (mbrojtje të Rregullorës së Garave), të publikuar në faqen zyrtare të FFK-së mund të ushtrojë ankesë tek KE i FFK-së 15 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare.
- 11 Komiteti Ekzekutiv I FFK-së duhet të merr vendim në ankesën e ushtruar më së largu 30 ditë nga dita e pranimit.
- 12 Afati i marrjes së vendimeve nga Komisionet e Cekura më lartë është 3 ditë nga ushtrimi i ankesës (Protokolimi, Pranimi me e-mail zyrtar). Në rast të mosmarrjes së vendimit brenda 3 ditëve konsiderohet që ankesa e palës është e refuzuar dhe palës I ipet e drejta e ushtrimit të ankesës në shkallë më të lartë në afatin më së largu 8 ditë nga ushtrimi I ankesës së protokoluar (email) në FFK.

Neni 86

- 1 Në situatë të jashtëzakonshme (gara e KUP-ës, ndeshjet e dy xhirove të fundit etj), me mund të parashihet procedure e posaçme në bazë të ankesës e kjo do të thotë, mund të parashihet që paralajmërimi, ushtrimi dhe vendosja mbi ankesën të bëhet në afate më të shkurtëra.
- 2 Kur xhirot zhvillohen të dielen dhe të mërkurën atëherë kompletimi i lëndës së ankesës bëhet brenda 24 orëve, kurse taksimi më së largu 48 orë nga përfundimi i ndeshjes së zhvilluar. Nëse afati për ushtrimin e ankesës skadon në ditën e shtune, dielë ose në ditën e festës shtetërore, afati për ushtrimin e ankesës vazhdon edhe në ditën e parë të ardhshme të punës.
- 3 Organi që udhëheq me garat është i obliguar që të shqyrtojë dhe vendos ankesën e paraqitur para fillimit të gjiros së radhës, qoftë kampionale apo e kupës.

Neni 87

- 1 Për çdo Ankesë duhet vendosur më së voni në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të saj.
- 2 Përjashtim bëjnë rastet kur marrja e vendimit mbi ankesë mvaret nga ndonjë vendim tjetër, të cilin duhet ta marrë një organ tjetër kompetent. Vendosja mbi ankesë do të shtyhet derisa të sigurohet vendimi definitiv i organit kompetent, por jo më larg se 15 ditë.

Neni 88

- 1 Për ankesat lidhur me garat e përhershme, në shkallë të parë vendosin organet të cilat udhëheqin me gara gjegjësisht Komisioni i Garave.
- 2 Mbi ankesat në vendimet e organeve nga pika paraprake, vendosin organet e parapara me Rregulloren e garave, gjegjësisht Komisioni mbi ankesa (shkalla e II-të).
- 3 Afati i rregullt për ushtrimin e ankesave kundër vendimit të organit të shkallës së parë, është 5 (pesë) ditë nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 89

- 1 Vendimi i shkallës së dytë duhet të mirret më së largu në afat prej 3 ditëve nga dita e protokollimit të ankesës-ose pranimit përmes email-it.
- 2 Nëse organi i shkallës së dytë nuk vepron në kuptim të pikës 1 të këtij neni, pala e pakënaqur ka të drejtë që pas 15 ditëve nga dita e protokollimit të ankesës t'i drejtohet Komitetit Ekzekutiv) KE për mbrojtjen e Rregullorës, duke konsideruar se nuk është aprovuar ankesa.
- 3 Komiteti Ekzekutiv duhet që të merr Vendim për çështjen më së largu 30 ditë nga ushtrimi i kërkesës për mbrojtje te Ligjshmërisë.
- 4 Ndaj vendimit të KE apo mosmarrjes së Vendimit me kohë nga ana e KE-së, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Arbitrazhit sportiv të KOK jo më larg se 60 ditë nga dita e protokollimit të kërkesës në KE.

Neni 90

- 1 Pas fletëparaqitjës së drejtpërdrejtë apo indirekte të klubit të dëmtuar, pastaj fletëparaqitjës së Delegatit apo Referit të ndeshjes, organit apo organizatës së futbollit, si dhe sipas detyrës zyrtare, organi që udhëheqë me gara do të regjistrojë ndeshjen me rezultat zyrtar 3:0 (parforfe) në dëm të klubit i cili ka bërë njëren prej kundërvajtjeve të cekura, respektivisht edhe me marrjen e një pike nga pikët e fituara, nëse ka kryer së paku dy nga këto kundërvajtje:
- 2 është paraqitur me lojtar i cili sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, nuk nuk është i moshës përkatëse (adekuate) për të luajtur për ekipin gjegjës.
- 3 ka luajtur me lojtar për të cilin nuk është paisur me ID(për vitin garues rrjedhës vitin që është në vijim e sipër).
- 4 ka luajtur me lojtar i cili nuk i përmbush kushtet e parapara me këtë Rregullore lidhur me kontrollimin mjekësor,
- 5 ka luajtur me lojtar i cili ditën e njejtë ka luajtur edhe në një ndeshje tjetër dhe ajo nuk lejohet me këtë rregullore.
- 6 Nëse të dy klubet kanë bërë nga një kundërvajtje atëherë dy klubeve u mirret nga një pike, ndërsa ndeshja e zhvilluar nuk regjistrohet me rezultatin e arritur, por e njejtë duhet të përseritet.
- 7 Nëse është në pyetje kundërvajtja në ndeshjen për kupë, atëherë ekipi i cili ka bërë kundërvajtjen eliminohet nga garat që dmth ekipi kundërshtar kualifikohet për garat e mëtutjeshme.
- 8 Nëse në dy klubet në atë ndeshje kanë kryer nga një kundërvajtje të cekur më lartë, atëherë të dy klubet do të eliminohen nga garat e mëtutjeshme.
- 9 Nëse në ndeshjet për kupë, me ardhje-vajtje, ndeshja e pare, për çfarëdo arsyeje regjistrohet me rezultat zyrtar (3:0), takimi i kthimit nuk luhet fare. Nëse kjo ngjanë në ndeshjen e dytë, atëherë ekipi i cili e humb me rezultat zyrtar (0:3), eliminohet nga garat e mëtutjeshme, pavarësisht nga rezultati i takimit të pare.

Neni 91

- 1 Në bazë të ankesës së ushtruar të klubit të dëmtuar do të mirret vendim mbi regjistrimin e ndeshjes me rezultat 3:0 (par-forfte) në favor të tij, nëse nuk ka arritur rezultat më të mirë dhe atë po qe se klubi kundërshtar:
- 2 ka luajtur me lojtar i cili nuk është i regjistruar për këtë klub.
- 3 ka luajtur me lojtar i cili në atë ndeshje nuk ka pasur të drejtë loje.
- 4 ka luajtur me lojtar, identiteti i të cilit nuk është vërtetuar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
- 5 ka luajtur me lojtar për të cilin me vendim definitiv të shkallës së dytë të organit kompetent për regjistrimin e lojtarëve, është vërtetuar se është regjistruar me zbatimin jo të rregullt të dispozitave të akteve mbi regjistrimin, ose në bazë të të dhënave jo të sakta.
- 6 Marrja e vendimit nga alinea paraprake, nuk ka vend nëse regjistrimi i lojtarit është vërtetuar me vendim definitiv të shkallës së dytë të organit kompetent për regjistrim të lojtarëve. Pa marrë parasysh se është në zhvillim e sipër procedura sipas Kërkesës për mbrojtjen e rregullore mbi regjistrimin e lojtarëve.
- 7 Komisioni për vërtetimin e regjistrimit i Komitetit ekzekutiv të FFK-së është organ i shkallës së dytë, i cili vendos mbi ankesat lidhur me regjistrimin e lojtarëve të FFK-së.
- 8 Ka luajtur me lojtar të regjistruar mirë por i cili nuk i plotëson kushtet sipas Propozicioneve të garave gjegjëse.
- 9 Ka luajtur me lojtar i cili gjendet nën dënim të ndalesës së lojës apo suspendim ose vetë ekipi është nën suspendim.
- 10 Ka luajtur me lojtar i cili nuk është shënuar në Raport para fillimit të ndeshjes.
- 11 Ka zëvendësuar (ndërruar) më shumë lojtarë në atë ndeshje se sa që lejojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.
- 12 Ka luajtur me lojtar i cili më parë është zëvendësuar (ndërruar) në atë ndeshje.
- 13 Ka luajtur me lojtar i cili është i regjistruar përveç në atë klub edhe në ndonjë klub tjetër (pra ka dy regjistrime).
- 14 Organi i cili udhëheq me gara, përveç regjistrimit të ndeshjes me rezultat zyrtar, është i obliguar që edhe të inicojë procedurën disiplinore para organit kompetent, kundër klubit dhe lojtarit.

Neni 92

- 1 Në bazë të ankesës së ushtruar të klubit të dëmtuar do të anulohet ndeshja dhe do të caktohet përseritja e saj (ndeshja e re), në këto raste:
- 2 Nëse klubi kundërshtar ka luajtur me lojtar i cili sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje nuk ka pasur të drejtë loje, ndërsa organi që udhëheqë me gara ka vërtetuar, se për këtë rrethanë klubi nuk ka pasur kurrfarë faj, dhe se klubi nuk ka pasur dijeni e as që ka mundur të dijë për faktet të cilat e kontestojnë rregullësinë e regjistrimit dhe paraqitjen e lojtarit kontestues.
- 3 Nëse klubi kundërshtar ka luajtur me lojtarin ose ekipin i cili është i dënuar me ndalesë loje ose është i suspenduar me vendimin e organit kompetent disiplinor, e për këtë nuk është i informuar me shkrim ose me telegraf, ashtu siq e parashohin dispozitat e Rregullore disiplinore, ose ka luajtur me lojtar i cili është nën dënim apo suspendim e që e ka ndërruar klubin, ndërsa kjo masë

disciplinore nuk i është shënuar me fletëregjistrim dhe në librezë të futbollit, e klubi për të cilin ka luajtur ky lojtar nuk është informuar në mënyrë të rregulltë për këtë fakt.

- 4 Për suspendim të menjëhershëm të shkaktuar më përjashtimin e lojtarit nga loja dhe dënim të menjëhershëm të shkaktuar për shkak të vërejtjeve publike të referit, nuk është e nevojshme të informohet me shkrim e as me telegraf klubi në ekipin e të cilit është kryer kundërvajtja, sepse përjashtimet dhe vërejtjet publike regjistrohen në protokoll të ndeshjes më të cilin gjithësesi disponon klubi.
- 5 Nëse vërtetohet se si njëri, ashtu edhe klubi tjetër kanë luajtur nën rrethana nga neni 87 i kësaj Rregulloreje.
- 6 Nëse klubi kundërshtar ka luajtur në ndeshjet e pionerëve, kadetëve apo juniorëve me lojtar moshë e të cilit është më e vjetër, që të luaj në këto ekipe dhe nëse vërtetohet se klubi nuk e ka ditur e as që ka pasur mundësi të dijë për këtë fakt.
- 7 Nëse referi nuk ka zbatuar ose gabimisht e ka zbatuar ndonjërin prej dispozitave esenciale të Rregullave të lojës së futbollit dhe vendimet e Bordit Ndërkombëtar dhe Komitetit ekzekutiv të FFK-së, ndërsa kjo shkelje e dispozitës ka ndikuar në epilogun përfundimtar të ndeshjes.
- 8 Nëse deri të anulimi i ndeshjes vjen për shkak të kundërvajtjes që parashohin pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, organi i cili udhëheq me gara është i obliguar që organit kompetent disiplinor t'i ushtrojë përveç tjerave edhe fletëparaqitjen për atë lojtar.
- 9 Në rast të anulimit të ndeshjes për shkak të kundërvajtjes nga pika 3 e këtij neni, përveç procedurës kundër lojtarit që parashihet me dispozitat e alinesë paraprake, organi që udhëheq me gara duhet të inicojë edhe procedurën disiplinore kundër klubit sipas dispozitave të Rregullores disiplinore.
- 10 Në rast të anulimit të ndeshjes për shkak të bazës të paraparë në pikën 5 të këtij neni organi i cili udhëheq me gara është i obliguar që organit kompetent disiplinor t'i ushtrojë fletëparaqitje kundër referit.

Neni 93

- 1 Shkelja esenciale e Rregullave të lojës së futbollit dhe vendimeve të Bordit Ndërkombëtar dhe të Komitetit ekzekutiv të FFK-së (në tekstin e mëtutjeshëm RREGULLAT E LOJËS), ekziston nëse Referi nuk e ka zbatuar ose gabimisht e ka zbatuar ndonjë dispozitë, me çka ka ndikuar drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes, po qe se ai vendim nuk trajtohet në sferën e bindjes së lirë të Referit.
- 2 Të gjitha vendimet që janë marrë në bazë të bindjes së lirë të Referit ("sipas mendimit të Refrit", "nëse Gjyqtari mendon", "sipas bindjes së Referit), nuk mund të futen nën kuptimin e shkeljes esenciale të dispozitave të Rregullave të lojës.

Shkelja esenciale e dispozitave të Rregullave të lojës ekziston:

Neni 94

- 1 Nëse ndeshja kampionale ose për kupë (në tekstin e mëtutjeshëm: ndeshjen) e drejton Referi i cili nuk është i deleguar nga organi kompetent, respektivisht nuk është vepruar sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe dispozitave të akteve normative të garave gjegjëse.

- 2 Nëse ndeshja zhvillohet në terren, dimensionet e të cilit nuk janë në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, me atë që klubi i cili e ka ushtruar ankesën, për një gjë të tillë Gjyqtarit i ka bërë kundërshtim me shkrim para fillimit të ndeshjes.
- 3 Nëse ndeshja është zhvilluar me më shumë se 11 lojtarë ose me më pak se 7 lojtarë.
- 4 Nëse pjesa e ndeshjes sipas orës së Referit ka zgjatur më shumë se 45 minuta, e që nuk ka qenë në pyetje kompensimi i kohës dhe për atë kohë të vazhduar është shënuar goli i cili ka ndikuar drejtpërdrejt në epilogun përfundimtar të ndeshjes,
- 5 Nëse nga gjuajtja e lirë indirekte është shënuar gol, të cilin referi e ka pranuar e që ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes.
- 6 Nëse gjatë hedhjes së topit me dorë në lojë (nga auti), lojtari e ka hedhur atë në portë (rrjetë) pa e prekur askush tjetër, kurse Gjyqtari e ka pranuar këtë gol, i cili ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes.
- 7 Nëse me rastin e lëshimit të topit nga dora apo trupin e Referit ("topi i Referit"), topi ka hyrë në portë (në rrjetë), kurse Referi e ka pranuar këtë gol i cili ka ndikuar drejtpërdrejtë në epilogun përfundimtar të ndeshjes.

Neni 95

- 1 Nëse ankesa ka të bëjë vetëm me parregullsitë e shkaktuara gjatë ekzekutimit të penalltive, me të cilat përcaktohet fituesi i ndeshjes pas zhvillimit të ndeshjes respektivisht edhe të vazhdimëve dy herë nga 15 minuta, atëherë organi kompetent nëse vërteton parregullsinë mund të bjen vendim vetëm për ekzekutimin e sërishëm të
- 2 penalltive, e jo edhe për përsëritjen e ndeshjes, po qe se loja e rregullt respektivisht vazhdimet dy herë nga 15 minuta janë zhvilluar sipas Rregullave të lojës.
- 3 Nëse me rastin e shqyrtimit të ankesës vërtetohet, se Referi gjatë zhvillimit të vazhdimëve të ndeshjes dy herë nga 15 minuta, ka bërë shkelje esenciale të Rregullave të lojës, e cila shkelje ka ndikuar drejtpërdrejt në epilogun përfundimtar të ndeshjes, ndeshja do të përsëritet dhe do të caktohet termini i ri për zhvillimin e saj.

ANULIMI I NDESHJEVE SIPAS DETYRËS ZYRTARE

Neni 96

- 1 Ndashja do të anulohet sipas detyrës zyrtare ndeshja do të caktohet zhvillimi i saj i sërishëm, po qe se vërtetohet se Referi i shtyrë nga motivet amorale ka ndikuar në epilogun përfundimtar të ndeshjes, e cila ju ka besuar ta referojë.
- 2 Deri te anulimi i ndeshjes mund të vjen në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës kompetente për veprë penale dhënia dhe marrja e mitos ose vendimit të plotfuqishëm të organit kompetent disiplinor për këtë veprë ose për veprë tjetër amorale të paraparë me aktet e përgjithshme normative e FFK-së.
- 3 Anulimi sipas kësaj baze mund të bëhet deri në përfundim të periudhës garuese. Inicimi i procedurës sipas fletparaqitjes apo detyrës zyrtare nga ana e organit kompetent garues, ka vend vetëm në kusht

që vendimi i plotfuqishëm nga aliena paraprake është bërë i plotfuqishëm deri në fund të periudhës garuese.

- 4 Me përfundim të periudhës garuese në kuptim të këtij neni, nënkuptohet dita kur organi kompetent garues e ka vërtetuar tabelën përfundimtare të garave gjegjëse.
- 5 Anulimin e ndeshjes mund ta bëjë organi që udhëheq me garat dhe nëse konstatohet se klubet kanë kurdisur rezultatin dhe organet gjegjëse hetimore dhe gjyqësore kanë vërtetuar një gjë të tillë. Kurdisje konsiderohet edhe dhënja e mitos lojtarëve, trajnerëve dhe zyrtarëve të klubeve për arritjen e rezultatit të dëshiruar me anë të mitos.
- 6 Nëse nga ana e organit kompetent vërtetohet se të dy klubet kanë marrë pjesë në kurdisjen e rezultatit, e njëjta do të regjistrohet si ndeshje e luajtur, rezultati i saj nuk do të regjistrohet gjegjësisht pikët dhe golat e shënuara nuk do të regjistrohen në tabelën e klasifikimit por që ndaj klubeve do të inicohet procedura disiplinore dhe do të dënohen sipas Rregullores disiplinore të FFK-së.
- 7 Nëse nga personat e tretë apo klubi i tretë bëhet kurdisja e rezultatit të ndeshjes në të cilën merr pjesë vetëm njëri klub-pjesëmarrës në ndeshje, rezultati i asaj ndeshjeje do të anulohet, do të caktohet ndeshja e redhe klubi fajtor do të dënohet sipas dispozitave disiplinore të FFK-së.
- 8 Dhënja e premive për fitore nuk konsiderohet mito. Ndaj të gjithë atyre që janë të involvuar në kurdisje të rezultateve do të inicohet procedura disiplinore.

Neni 97

RESPEKTIMI I SPONZORIT

- 1 FFK është pronare e të drejtave televizive dhe të tjera të lidhura me to.
- 2 Federata e Futbollit e Kosovës ka të drejtë të kërkojë sponzorë për çdo ligë veç e veç.
- 3 Në bazë të detyrimeve të dyanshme mes sponzorit të ligës përkatëse dhe FFK-së, klubet e rangut përkatës kanë obligim respektimin e lëndës së marrëveshjes, e cila i lehtëson klubet.
- 4 Klubi i cili nuk i respekton obligimet e përcaktuara mes sponzorit të ligës dhe FFK-së, do të dënohet në bazë të Rregullores disiplinore.

XXIII OBLIGIMET MATERIALE TË KLUBEVE NDAJ FFK-SË DHE ORGANEVE ZYRTARE

Neni 98

- 1 Klubet e futbollit janë të liruara nga kuotizimet deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga KE, ndërsa Superliga do të quhet sipas kontratës për Sponzorizim të nënshkruar mes FFK-së dhe sponzorit.
- 2 Klubet janë të obliguara që të respektojnë obligimet e dala nga marrëveshja me sponzorin e Ligës përkatëse.
- 3 Të gjitha klubet janë të obliguara të paguajnë anëtarësinë për futbollistët e tyre (nëse nuk merret ndonjë vendim ndryshe). Vlera në para rregullohet me Vendim nga KE në fillim të çdo cikli garues. Ky licencim vlen për një kampionat. Në rast të ndërrimit të ID së lojtarëve, shpenzimet e ndërrimit të saj i bartë klubi, qoftë nëse ID ka humbur apo është dëmtuar apo për arsye të tjera ajo është dashtë

me u ndërruar. Klubet duhet që këto obligime financiare ndaj FFK-së, t'i përmbushin më së voni 15 ditë para fillimit të garave (para stinorit).

Neni 99

- 1 Taksat dhe mëditjet për personat zyrtarë Refer-kryesor, anësorë, Delegat të ndeshjes, Refer të katërt, Kontroll i Referimit, caktohen me Vendim nga KE i FFKsë, për çdo cikël garues.
- 2 Taksat dhe të gjitha pagesat për Garat e futbollit të femrave dhe të Futsal-it, përcaktohen me Vendime të veçanta. Shpenzimet, personave zyrtarë iu paguhen para fillimit të ndeshjes apo edhe pas përfundimit të ndeshjes.
- 3 Në rast se ekipi nuk i paguan personat e deleguar, nuk i delegohen zyrtarët për ndeshjet e ardhshme dhe të njëjtën e humb me rezultat zyrtar Parforfe (3:0). Nëse ndeshja nuk ka përfunduar me kohë siç e parashikojnë dispozitat e kësaj Rregullore dhe e njëjta përsëritet,
- 4 Shpenzimet e personave zyrtar i paguan ekipi nikoqir, ndërsa shpenzimet e rrugës së ekipit mysafir i paguan vet ekipi mysafir. Kur kërkesën për kontrollë të posaçme e bënë klubi, atëherë shpenzimet për personin zyrtar e bënë (pagan) klubi i cili ushtron një kërkesë të tillë, dhe atë në emër të mëditjes, ndërsa taksat për ndeshjet e Superligës dhe të Ligës së I-rë, ligës së II-të caktohen me Vendim nga KE ne fillim te ciklit te garave.
- 5 Në rast të moszhvillimit të ndeshjes, personave zyrtar të ndeshjes (kontrollori, referët) ekipi nikoqir duhet t'ua paguaj mëditjen dhe shpenzimet e udhëtimit.

Neni 100

- 1 Nëse lojtari ndëshkohet me karton të kuq apo me dy kartona të verdhë brenda një ndeshjeje (kartoni i kuq), atëherë ekipi i tij ndëshkohet me të holla, sipas Vendimit nga KE me të cilin rregullohet shuma e kartonit të kuq-direkt, 2 kartonave të verdhë, kartonit të verdhë.
- 2 Nëse trajneri ndëshkohet me karton të kuq, ekipi i tij do të dënohet me gjobë në të holla të cilën e përcakton KE sipas Vendimit të marrë në fillim të ciklit të garave.
- 3 Nëse anëtarët e udhëheqësisë së klubeve, kryejnë çfarëdo kundërvajtje në garat e futbollit dhe lidhur me garat e futbollit, atëherë klubet e tyre do të dënohen me gjobë sipas Rregullores disiplinore, varësisht nga rangu i garave dhe pesha e veprës.
- 4 Nëse brenda një stinori (vjeshtë apo pranverë), i njëjti futbollist, trajner apo punëtor sportiv, e përsëritë deliktin për të cilin dënohet sipas dispozitave të alineve të lartëtheksuara të këtij neni, atëherë, lartësia e dënimit të tij dyfishohet.
- 5 Lojtari apo zyrtarët e klubit, ndaj të cilët ndëshkohen gjat lojës me kartona (verdhë apo kuq) dhe ndaj tyre shqiptohet edhe masa e kundërvajtjes në para, nuk mundën të paraqiten në ndeshje zyrtare të radhës pa u paguar gjoba (ose gjoba të shëndërrohet në ndëshkim me ndeshje).

Neni 101

- 1 Secili ekip është i obliguar, që para zhvillimit të ndeshjes së xhiros në rradhë, t'i paguaj FFK-së, të gjitha dënimet në të holla, për kartuqa të kuq si dhe dënimet tjera në të holla që ia kanë shqiptuar organet kompetente të FFK-së,
- 2 Në të kundërtën, ky ekip do të pezullohet (nuk ka të drejtë loje) nga garat e ardhshme.

- 3 Të gjitha obligimet financiare ndaj FFK-së, që rrjedhin nga Rregullorja e Garave, duhet të kryhen në xhirollogarinë zyrtare të FFK-së.

DISPOZITAT E POSACME

XXIV MBROJTJA E RREGULLORËS

Neni 102

- 1 Ne baze të kësaj Rregulloreje, pos klubit të dëmtuar, komisioni për akte normative i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së (me vetëiniciativë apo me propozimin e subjekteve të interesuara) kur vlerëson se janë shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje, mund të ushtrojë Kërkesën për mbrojtjen e Rregullores mbi garat e futbollit.
- 2 Komisioni për akte normative-(apo palët e interesuara) i Komitetit Ekzekutiv të FFK-së e ushtron kërkesën për mbrojtjen e kësaj Rregulloreje në rastet kur janë në pyetje vendimet që i kanë marrë organet e Komitetit Ekzekutiv, respektivisht organet tjera, e që kanë të bëjnë me klubet e të gjitha rangjeve të garave të Kosovës, si dhe kur është fjala për vendimet e paharmonizuara të dy apo më shumë organeve ekzekutive të tij.
- 3 Kërkesa për mbrojtjen e Rregullores së garave të futbollit, mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 4 Kërkesa i ushtrohet me shkrim Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, përmes organit i cili ka marrë vendimin definitive.
- 5 Nga Kërkesa për mbrojtjen e Rregullores nuk mund të hiqet dorë, nëse sipas propozimit të organit kompetent ka filluar procedura e paraparë me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Neni 103

- 1 Për Kërkesën mbi mbrojtjen e Rregullores së garave të futbollit vendos Komiteti Ekzekutiv i FFK-së. Nëse organi kompetent nga alinea paraprake e vërteton se Kërkesa për mbrojtjen e rregullores mbi garat e futbollit është e bazuar, atëherë do të marr vendim mbi prishjen e vendimit të atakuar përfundimtar, duke ia kthyer lëndën organit kompetent (Komisionit për ankesa të shkallës së II-të), që sërish të vendosë për atë lëndë.
- 2 Nëse Komiteti Ekzekutiv i FFK-së e sheh të arësyeshme, atëherë do të vendos vetë për atë lëndë.
- 3 Vendimi i Komitetit Ekzekutiv nga alinea paraprake, nuk mund të atakohet me asnjë mjet juridik.

Neni 104

- 1 Komiteti Ekzekutiv i FFK-së pas shqyrtimit të Kërkesës për mbrojtjen e Rregullores, mund të vendos që ta prish vendimin duke ia kthyer lëndën në shqyrtim të sërishëm organit kompetent, i cili është i obliguar që të ndërmarrë veprimet konkrete për t'i shqyrtuar të gjitha ato çështje për të cilat i ka sugjeruar Komiteti Ekzekutiv i FFK-së.

- 2 Nëse rastet kur organi të cilit i është kthyer lënda në shqyrtim, nuk vepron sipas vërejtjeve dhe sygjërimeve të Komitetit Ekzekutiv të FFK-së, atëherë ky organ (Komiteti Ekzekutiv) për këtë lëndë do të vendos sipas detyrës zyrtare.

Neni 105

- 1 Nëse Komiteti Ekzekutiv i FFK-së, e vërteton në çfarëdo mënyrë, se organet kompetente për zbatimin e kësaj Rregulloreje, nuk i kanë përfilluar dispozitat e kësaj Rregulloreje si në aspektin material ashtu edhe në atë procedural gjatë vendosjes mbi çështjet e caktuara në garat e futbollit, atëherë Komiteti Ekzekutiv ka të drejtë që sipas detyrës zyrtare të marrë vendimin definitiv mbi atë çështje, kurse ndaj anëtarëve të organeve të tilla të inicojë procedurën disiplinore dhe të kërkojë apo të shqiptojë masat konkrete të parapara me aktet normative të FFK-së.
- 2 Vendimi i Komiteti Ekzekutiv nga alinea paraprake nuk mund të atakohet me asnjë mjet të rregullt juridik të FFK-së.
- 3 Ndaj Vendimit të Komitetit Ekzekutiv (ose mos marrjes të ndonjë vendimi me kohë), pala e pakënaqur mund ti drejtohet Arbitrazhit Sportiv, në Komitetin Olimpik të Kosovës si dhe në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë CAS.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 106

Vendimet obligative për zbatimin e Rregullave të lojës së futbollit të marra nga ana e organeve kompetente ekzekutive të FFK-së, para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje do të zbatohen edhe më tutje gjithnjë, derisa çështja që rregullohet me këto vendime mos të rregullohet me akte të përgjithshme normative të FFK-së.

Neni 107

Komiteti Ekzekutiv i FFK-së është i autorizuar që të jep udhëzime për zbatimin e kësaj Rregulloreje dhe të bëjë interpretimin e dispozitave të saj.

Neni 108

Rregullorja është aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv i FFK-së me 5 Gusht 2009, ndërsa plotësimet dhe ndryshimet janë miratuar me 02.08.2017.

Rregullorja hyn në fuqi një ditë pas nënshkrimit të saj.


Agim Ademi
Kryetar




Eroll Salihu
Sekretar i Përgjithshëm

KOMUNIKIMI

Komunikimi i paleve-klubeve, zyrtareve te klubeve zyrtareve te FFK-se, behet permes mjeteve elektronike, permes arkivit te FFK-se, ne raste edhe permes tel.

- Sekretari Gjeneral i FFK-se
Eroll Salihu
Tel. 049 979 001
erollsalihu@ffk-kosova.com

- Zv.Sekretari Gjeneral/zyra Ligjore e FFK-se
Arianit Ahmeti
Tel.049 979 002
arianitahmeti@ffk-kosova.com

- Departamenti i Financave
Agim Gashi
Tel. 049 979 013
financat@ffk-kosova.com.

- Komisioni i Garave
Avdyl Bellopoja
Tel.038/600-220
Mob.
Email: komisionipergara@ffk-kosova.com

- Komisioni Disiplinor
Dukagjin Zefi
Tel.038/600-220
Mob. 044-307 503
komisionidisiplinor@ffk-kosova.com

- Komisioni I Apelit
Tel.038/600-220
Mob.
komisioniiapelit@ffk-kosova.com

Administrata e FFK-se-Sektor i Garave

Tel.038/600-220

Mobil.

Email sektoripergara@ffk-kosova.com

- Agron Shosholli, Superliga/Liga I
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-020
Email agronshosholli@ffk-kosova.com

- Baki Berisha, Liga II (A-B)
Tel. 038/600-220
Mob.049-979-021
Email bakiberisha@ffk-kosova.com

- Valon Sadiku, Superliga-U19/ Liga I-U19/ Superliga-U17/
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-090
Email - valonsadiku@ffk-kosova.com

- Valbona Gashi, Superliga Femra "A"/ U16/
Tel.038/600-220
Mobil.049-979-016
E-mail valbonagashi@ffk-kosova.com

Prishtinë,

30/07/2019